



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

PROÇESVERBAL

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Ditën e martë, datë **1.04.2025**, ora 14:00 në ambjentet e Qendrës për Hapje dhe Dialog, Salla e Librarisë në Kryeministri, u mbajt mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile për vitin 2025. Anëtarë të pranishëm në mbledhje ishin:

Për anëtarët përfaqësues të **institucioneve publike**:

1. Znj. Denada Seferi –Zv/Ministre - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Znj. Evis Qaja – Kryeministria, Departamenti i Politikës dhe Integritimit Evropian/ Ministër Shtetit dhe Kryenegociator
3. Z. Sofjan Jaupaj – Zv/Ministër - Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
4. Znj. Orjana Arapi – Zv/Ministre - Ministria e Arsimit dhe e Sportit
5. Z. Albin Gega - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
6. Z. Albi Greva - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
7. Znj. Margarita Vogli – Ministria e Brendshme
8. Znj. Arlinda Topçiu – Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
9. Z. Oltion Pengu - Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
10. Znj. Anxhela Kenaj - Ministria e Drejtësisë
11. Znj. Gentiana Dervishi - Ministria e Drejtësisë
12. Znj. Eni Memishahi- Kryeministria, Departamenti i Politikës dhe Integritimit Evropian/ Ministër Shtetit dhe Kryenegociator
13. Znj. Etleva Sheshi - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për anëtarët përfaqësues **të shoqërisë civile** në Këshill:

1. Z. Vladimir Thano –N/Kryetar i Këshillit
2. Z. Indrit Seferi
3. Z. Ergys Gezka
4. Znj. Fabiola Laço Egro
5. Z. Altin Hazizaj
6. Znj. Ermelinda Mahmutaj
7. Z. Nensi Dragoti
8. Znj. Eglantina Bardhi

Përfaqësues nga **AMSHC**:

1. Znj. Eniana Koçiaj
2. Znj. Andia Ndreka

Pjesëmarrës **të tjerë**:

1. Znj. Natasha Mazari – EU TACSO
2. Z. Granit Sokolaj – Qendra “ALERT”
3. Znj. Ariola Agolli – Partners Albania
4. Z. Jursi Temali – Startup Albania
5. Z. Erni Koçuni – URI

Axhenda e takimit:

1. Fjala e hapjes dhe aprovimi i rendit të ditës – Z. Vladimir Thano;
2. Përditësime mbi çështjet e ngritura nga mbledhjet paraprake- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile;
3. Prezantim i problematikave të hasura nga shoqëria civile në kuadër të tkurrjes së burimeve financiare nga donatorët ndërkombëtarë - Z. Vladimir Thano, Nënkyetar i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile;
4. Procesi i integritetit të Shqipërisë në BE, roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë proces - Znj. Evis Qaja, Kryeministria, Departamenti i Politikës dhe Integritetit Evropian/ Ministër Shtetit dhe Kryenegociator
5. Efikasiteti i Ligjit për Sponsorizimet - z. Altin Hazizaj, anëtar i KKShC-së;
6. Prezantime mbi mbështetjen financiare për shoqërinë civile - Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Znj. Arlinda Topçiu, Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit- Z. Sofjan Jaupaj, MEKI – Z. Albin Gega dhe nga AMSHC – Znj. Eniana Koçiaj;
7. Diskutime.

Znj. Denada Seferi: Përshëndetje të nderuar pjesëmarrës dhe anëtarë të KKSHC. Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj. Më lejoni fillimisht të miratojmë Axhendën e propozuar për mbledhjen e sotme.

Z. Vladimir Thano: Znj. Seferi kam diçka për procedurë. Në rregulloren e Këshillit konkretisht neni 16 pika 1 thuhet se drejtimi i mbledhjes në mugesë të Kryetarit bëhet nga Nënkyetari i Këshillit nga shoqëria civile. Gjithashtu kemi nevojë të shohim nëse mbledhja është legjitime, pra a është kuorumi i mjaftueshëm nga përfaqësuesit e qeverisë për të vazhduar mbledhjen.

Znj. Denada Seferi: po Z. Thano mund të vazhdoni me drejtimin e mbledhjes.

Z. Ergys Gezka: është e disata herë që vimë në mbledhje dhe nuk është e pranishme Kryetarja e Këshillit, dhe në çdo mbledhje vinë persona të rinj. Kjo është e papranueshme, mbledhja nuk duhet të zhvillohet. Axhenda ka ardhur me vonesë dhe ndërkohë në Axhendë shkruhet që fjalën

e hapjes e ka Znj.Koçiu. Nuk e dinit ju Znj.Seferi që nuk do të ishte e pranishme? Përse nuk u lajmërua?

Znj.Denada Seferi: Ministrja ndodhet jashtë Shqipërie, dhe jo nuk e dinim që nuk do të ishte e pranishme, e morëm vesh dje pasi ishte shpërndarë Axhenda e takimit.

Znj.Eglantina Bardhi: Na thoni se edhe ne nuk e kemi të tepërt kohën, sjellim sekretaret tona.

Znj.Eniana Koçiaj: Në rregulloren e Këshillit është e përcaktuar që anëtarët e Këshillit nga qeveria duhet të jenë ose në rang Zv. Ministri ose Drejtorë të Përgjithshëm të cilët mund të përfaqësohen në Këshill.

Z. Vladimir Thano: Jo kjo nuk është e përcaktuar në Rregullore. Në bazë të rregullores së miratuar të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, duhet të saktësoj pikën 4. Përfaqësuesit e institucioneve publike në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, që përmenden në pikën tre dhe janë Ministrinë e këtij neni duhet të jenë në nivel zëvendësministrash ose duhet të jenë në nivele drejtuesish. Institucioni publik cakton përfaqësuesin e tij në KKSHC, si dhe zëvendësin përkatës brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ne jemi pikërisht në këtë moment a ka legjitimitet, unë pyes Sekretariatën në këto momente, a janë paraqitur zëvendësuesit e institucioneve përkatëse publike që ne t'i quajmë palë të legjitimuar në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile?

Znj. Eniana Koçiaj: Patjetër që po, ne përveçse i dërgojmë shkresa zyrtare institucioneve përkatëse, sigurisht që kemi dhe komunikim të shpejtë me e-mail. Këta janë të gjithë të deleguar nga Ministrat dhe Zv. Ministrat. Madje, kemi prezencë të zëvendësministrave në këtë tavolinë.

Z. Vladimir Thano: Atëherë a mund të bëjmë një apel nëse është e nevojshme? Atëherë, Kryeministria një anëtar?

Znj. Evis Qaja: Këtu, prezent.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Drejtësisë?

Znj. Anxhela Kenaj: Këtu.

Z. Vladimir Thano: A mund të uleni këtu në tavolinë?

Znj. Eniana Koçiaj: E keni kërkuar vetë mbledhjen këtu, këto janë kushtet. Po ta kishim bërë tek Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale do kishim më shumë hapësirë në tryezë për mbledhjen.

Z. Vladimir Thano: Ne mbledhjen e kërkojmë atje ku ligji e përcakton. Ministria e Punëve të Brendshme?

Znj. Margarita Vogli: Këtu.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Integrimit Europian?

Znj. Eniana Koçiaj: nuk ekziston më kjo Ministri Z. Thano, prandaj është i nevojshëm ndryshimi i Ligjit.

Znj. Denada Seferi: Është Kryeministria ose Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Znj. Evis Qaja: Këtu për dy funksione.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Financave?

Znj. Eniana Koçiaj: Nuk ka ardhur.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit?

Z. Sofjan Jaupaj: Këtu.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Shëndetsisë?

Znj. Denada Seferi: Ministria e Shëndetsisë dhe e Mirëqënies Sociale këtu.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Arsimit dhe e Sportit?

Znj. Orjana Osmani: Këtu.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Kulturës?

Z. Albin Greva: Këtu.

Z. Vladimir Thano: Ministria e Mirëqënies Sociale dhe e Rinisë?

Znj. Danada Seferi: Kemi dhe znj. Etleva Sheshi këtu.

Znj. Etleva Sheshi: Këtu.

Znj. Arlinda Topçiu: Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, këtu.

Z. Vladimir Thano: Ministri i Shtetit Për inovacion dhe Administratën Publike?

Z. Albin Gega: MEKI, jam këtu. Gjithmonë une e kam përfaqësuar MEKI-n në këtë Këshill.

Z. Vladimir Thano: Dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile?

Znj. Denada Seferi: Pra, jemi në rregull me kuorumin?

Z. Vladimir Thano: Në këtë fazë jemi në rregull.

Z. Ergys Gezka: A je i bindur Vladimir që je në rregull?

Z. Vladimir Thano: Sipas Ligjit, po.

Z. Ergys Gezka: Sipas përcaktimit që ti i bërë apelit, jemi në rregull. Sipas personave që janë të dizenjuar për të qenë në këtë tryezë a je i bindur që jemi në rregull? Kjo është një pyetje nga ana ime sepse nuk dua të bëj opozitën e situatës këtu.

Z. Vladimir Thano: Tani kjo është pyetje për institucionet?

Z. Ergys Gezka: jo kjo është një pyetje sepse sa herë jam ulur këtu kam parë gjithmonë persona të rinj në këtë tryezë përveç disa personave.

Z. Vladimir Thano: Më duhet t'i referohem sërish rregullores.

Z. Altin Hazizaj: Jo, doja të ndërhyja për të mbështetur dhe për të gjetur një zgjidhje, sensi do të jetë pozitiv domethënë. Që të mos bëjmë pyetje, sepse nuk besoj se kemi nevojë të bëjmë pyetje secili e merr vetë kuptimin e përfaqësimit. Çështja e përfaqësimit ka qenë gjithmonë problem që do të thotë ne mund të vendosim minutat e takimit, që përfaqësuesit e shoqërisë civile shprehin shqetësimin se niveli i përfaqësimit nuk është ai i duhuri dhe i rekomanduari nga ligji për KKSHC-në dhe kjo pastaj i duhet njoftuar ministrave përkatës në të gjitha ministrinë përfaqësuesit e stafit dhe këshillatërëve ku i kanë. Kjo mund të jetë diçka që ne mund ta monitorojmë për mbledhjen e ardhshme e në vazhdim. E zgjidh kjo situatën, një shënim i tillë në minuta? Kjo ka legjitimitetin, flas si avokat, jemi në rregull ligjërisht. Pyetja është gjithmonë a është ky përfaqësimi i duhur apo jo?

Znj. Ermelinda Mahmutaj: Për të ndjekur të njejtën linjë që tha Altini, ndoshta na ndihmon të kuptojmë. Eniana sa herë që ti koordinon merr një emër të ri apo institucioni e përcakton zëvendësministrin dhe përfaqësuesin e tij që prej fillimi? Në kuptimin që ka një dërgesë zyrtare siç janë anëtarët e shoqërisë civile që nëse nuk vjen zëvendësministri vjen përfaqësuesi i tij është prej fillimi dhe këto nuk ndryshojnë apo sa herë ne bëjmë mbledhje ti pret emrin që do të vijë?

Znj. Eniana Koçiaj: E përcakton institucioni, Ministri. Sa herë që ka ndryshime në qeveri ne bëjmë përsëri kërkesë dhe pastaj në varësi të personit që caktohet dërgohen lajmërimet për mbledhjet.

Znj. Ermelinda Mhamutaj: Pra është një procedurë dinamike, nuk mund të përcaktohet prej fillimi. Por, përsa i përket legjitimitetit dhe kuorumit ne biem të gjithë dakort që jemi në rregull.

Z. Vladimir Thano: po, kuorumi ekziston. Mirë, atëherë do të duhet për të hapur mbledhjen e takimit të miratojmë axhendën paraprake e cila është dërguar dhe më tej të fillojmë mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, jemi dakort me axhendën e paraqitur?

Z. Altin Hazizaj: Teknikalitet, do të duhet të miratojmë minutat e mbledhjes së kaluar që nuk i kemi, por shikojeni edhe këtë sepsë është procedurë edhe kjo. Minutat janë miratuar në mbledhjen e ardhshme gjithmonë.

Z. Vladimir Thano: Minutat janë të aprovuara për sa kohë janë dërguar. Gjithsesi ai e ka për procedurë dhe është e saktë sepse në minutat e takimit të fundit, çdo njeri i cili ka pasur për të redaktuar ose për të shtuar diçka që është mbajtur apo nuk është mbajtur është dërguar nga sekretariati.

Znj. Eniana Koçiaj: Ky është një komunikim që ne e kemi bërë me e-mail në fakt dhe nuk mund të presim 4 muaj për të miratuar e pastaj publikuar minutat e mbledhjes kam përshtypjen.

Z. Vladimir Thano: Për mua quhet e miratuar në mbledhje, për mua quhet e miratuar për sa kohë është shpërndarë. E miratojmë atëherë? Ok, dakort. Më duhet ti jap fjalën zonjës Seferi.

Znj. Denada Seferi: Mirë, shumë faleminderit Vladimir, në fakt unë do të doja që t'ju përditësoja me një letër të hapur që 86 organizata të shoqërisë civile kanë dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku ata kanë pasur disa nga çështjet të cilat kanë qënë të patrajuara sipas tyre përse i përket disa pikave që kanë lidhje me Udhërrëfyesin për Shoqërinë Civile, i cili në fakt është një raport i hartuar nga një nga ekspertët, nga TACSO, me aprovimin sigurisht dhe të Delegacionit Evropian. Dhe ky Udhërrëfyes është ndarë me ju në mos gaboj në vitin e kaluar përse i përket të gjithë çështjeve që trajtohen aty dhe kanë qënë pjesë e diskutimeve tona dhe e tryezave tona. Në fakt, çështja që është ngritur është që duhet të jetë transparent dhe duhet të jetë i publikuar. Në fakt, në një nga rekomandimet e këtij Udhërrëfyesi por edhe një nga çështjet të cilat janë ngritur edhe nga Kryenegociatorja dhe nga Delegacioni Evropian ka qënë çështja e përkatësisë të këtij Këshilli Kombëtar të Shoqërisë Civile apo të çështjes së cila ministri e linjës do të trajtonte pikërisht KKSHC për të cilën do të duhej një strukturë e përcaktuar qartë nga Kryenegociatorja, nga zyra e Kryenegociatores dhe sigurisht dhe nga ana qeverisë shqiptare. Ju bëj me dije që ka ardhur një shkresë nga Kryenegociatorja dhe është bërë me dije dhe delegacioni evropian dhe ministria jonë që kjo çështje i përcaktohet apo i shtohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Çështja për të cilën ne ende nuk e kemi bërë këtë Udhërrëfyes dhe këtë Raport Monitorimi transparent dhe nuk e kemi kaluar është sepse kemi marrë akoma komente që kanë të bëjnë me çështje të trajtuara në këtë Udhërrëfyes dhe në këtë Raport Monitorimi. Të gjitha komentet që janë marrë janë reflektuar në këtë Raport Monitorimi dhe shpejt drejtoria përkatëse do t'jua ndajë.

Së fundmi, ne kemi miratuar një strukturë të re dhe është një drejtori e përfshirjes sociale. **Brenda drejtorisë së përfshirjes sociale do të jetë pikërisht çështja e atashimit të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile** si një detyrim i cili do të rrjedhë për ta, pra për këtë drejtori dhe do të vijojë punën në vazhdimësi. Duke qënë se ne e dimë shumë mirë që jemi përpara zgjedhjeve dhe nuk kemi mundësinë as të drejtën që të emërojmë njerëz, sot jemi në fazën që nuk kemi një drejtues të kësaj drejtorie të përfshirjes sociale, kështuqë me vendosjen dhe me

emërimin e tyre dhe të të gjithë punonjësve të kësaj drejtorie do t’jua bëjmë me dije dhe do të kalojmë të gjithë çështjen e cila ka të bëjë me drejtimin apo strukturën përkatëse që do të jetë brenda MSHMS-së. Siç jua thashë është bërë me dije edhe delegacioni europian i cili do të vijojë më tej edhe me procedurën, jo vetëm të Raporti të Monitorimit dhe Udhërrëfyesit, por edhe të finalizojë tij. Me marrjen e këtij drejtimi, tani do të vijojmë dhe do të përmbyllim edhe Raportin e Monitorimit, në vazhdimësi kemi bërë me dije dhe delegacionin europian dhe ata do të na mbështesin. Do të mbyllim dhe komentet e fundit dhe do ta ndajmë me ju në mënyrë të menjëhershme.

Kjo ishte çështja e parë, **çështja e dytë, hartimi i Udhërrëfyesit** duhet të përfshijë konsultime të gjëra me organizata të shoqërisë civile, e cila është kërkuar në këtë letër të hapur dhe që në fakt është kërkuar që në nisje të procesit. Në dijeninë time ka patur një proces transparent i cili i ka përfshirë të gjitha organizatat e shoqërisë civile për të hartuar deri në momentin që është hartuar Rapoti i Monitorimit të Udhërrëfyesit, por pavarësisht kësaj ndoshta në këtë fazë në të cilën jemi mund të trajtohet edhe në një takim tjetër, përsëri me organizatat e shoqërisë civile ku të ndahet ky Raport Monitorimi dhe nëse do të ketë përsëri komente apo do të na duhet një kalendar apo etj. do të mund ta bëjmë dhe të jemi të hapur ndaj kësaj gjëje. Gjithësesi ne do ta ndajmë Raportin e Monitorimit të Udhërrëfyesit dhe secili nga ju mund të ketë elektronikisht këtë Raport. Pavarësisht se me ju është ndarë gjërësisht, është diskutuar gjërësisht dhe ne jemi në fazën finale të tij.

Së treti, pika e tretë që na është drejtuar në këtë letër të hapur është që qeveria duhet të tregojë vullnet dhe angazhim më të fortë politik në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Udhërrëfyesit për hartimin e politikës së masave për një mjedis më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile. Besoj se kjo e ka marrë tashmë rrugëtimin, është një drejtori përkatëse me dy sektorë me një drejtues, të cilët do të vijojnë që të ndjekin dhe të trajtojnë të gjitha çështjet që janë pjesë e Udhërrëfyesit por edhe me tej se nuk është vetëm çështja e raportit të Udhërrëfyesit, do të kemi dhe hartimin e ligjit, për rishikim e ligjit dhe gjëra të tjera që do të diskutohen në këtë mbledhje të KKSHC.

Pika e katërt është financimi publik për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe jo më kot në këtë axhendë të cilën në fakt e kemi trajtuar ne dhe e kemi diskutuar gjërësisht kemi një pikë të posaçme ku të gjithë ministrinë e linjës të cilat kanë hapsira për financa publike për sektorin e tretë që është shoqëria civile janë këtu për të dhënë të gjitha burimet e mundshme të cilat kanë të bëjnë me financimin publik të organizatave të shoqërisë civile. Kështuqë këtu jemi për të dëgjuar prezantimin e tyre dhe mënyrën sesi ato funksionojnë brenda ministrive të tyre për çështjen e financimit të organizatave të shoqërisë civile. Kështu të katër pikave të kësaj letre të hapur ju kemi dhënë në një farë mënyre drejtim përse i përket diskutimeve në këtë axhendë të KKSHC. Ne kemi menduar që pas trajtimit të këtyre çështjeve këtu mund të kthejmë dhe një përgjigje të letrës së hapur por për të qenë transparent me ju do të donim ta

diskutoni këtu letër të hapur këtu brenda kësaj tryeze, gjë të cilën unë sapo e prezantova. Kështuqë shumë faleminderit dhe mund të vijojmë me pikën tjetër.

Z. Vladimir Thano: Zonja Seferi faleminderit për përditësimin në lidhje me çështjet e ngritura nga shoqëria civile dhe të ardhur nëpërmjet organizatës Partnerët Shqipëri, duke i falenderuar natyrshëm por edhe duke të falenderuar dhe ty për shkak se kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm midis antarëve të Këshillit dhe ju personalisht, përse i përket çështjeve të adresuara kemi gjetur gjithmonë një koherencë për t'i dhënë jo vetëm zgjidhje por edhe për të qënë të hapur dhe transparent. Kështuqë mendoj se ajo që ju thatë është me shumë vend dhe mendoj që letra e cila do t'i dërgohet le të themi palës e cila e ka dërguar të ketë pikërisht edhe zërin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile. Natyrisht Këshilli Kombëtar të Shoqërisë Civile e ka pjesë të saj integrale dhe çështjet që lidhen me mjedisin mundësues por kjo është pikë së pari një detyrim shtetëror pasi rrjedh nga një vendim i Këshillit të Ministrave ku ai hyn në fuqi po për ne ai shërben si një kushtetutë e mirë përse i përket këtyre çështjeve. Nuk e di keni diçka tjetër për të shtuar?

Znj. Denada Seferi: Jo, nuk kam.

Znj. Fabiola Egro Laço: Unë vetëm një saktësim kisha ashtu siç tha dhe Vladimiri, ne jemi organ konsultativ rekomandues, këshillimor, dhe faleminderit zonja Denada që e ndave me ne se mesa di, unë jam një nga ato organizata që kam nënshkruar atë letër dhe duke pasur komunikim me to letra duhet të ishte me gjithëpërfshirëse, por mesa di unë letra nuk i drejtohet KKSHC dhe këtu në bëhemi me dije që do të ketë një drejtor dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Kjo është një arritje sepse ne do të punojmë me këtë drejtor dhe do jemi mbështetje që çdo lloj organizate apo iniciative që i drejtohet qeverisë apo ministrive të ndryshme bën mirë që të konsultohet më parë me KKSHC. Në këtë moment ne marrim një pozicion tjetër si Këshill dhe bëhemi më të dukshëm dhe me dashje ose pa dashje nga aktorë të ndryshëm duhet që të njihemi. Ju faleminderit.

Znj. Eniana Koçiaj: Do të doja të bëja një përditësim sa i përket edhe çështjeve që diskutuam nga mbledhja e fundit, ju faleminderit. Kemi qënë bashkë në kontakt me znj. Fabiola dhe znj. Mirela, ka qënë një problematikë shumë e rëndësishme që ka ardhur nga sektori i shoqërisë civile në lidhje me bankat e niveli të dytë. Ne si Sekretariat kemi organizuar një takim formal me Shoqatën e Bankave, me drejtuesin Z. Spiro Brumbulli, të cilin sigurisht që e ftuam të ishte i pranishëm këtu por e kishin të pamundur. Unë jo më larg se para dy orësh ju dërgova një e-mail, të cilin ndoshta nuk keni patur mundësi ta lexoni, por sidoqoftë ishte në thelb një përshkrim i kuadrit rregullator dhe ligjor.

Z. Altin Hazizaj: Për terrorizmin sqaroje të lutem. Për terrorizmin të lutem sqaroje për t'i vendosur pikat mbi 'i'.

Z. Vladimir Thano: Ja ta mbarojë.

Z. Altin Hazizaj: të lutem se ka shumë rëndësi për mua. Se nuk ka fyerje më të madhe se të marrësh atë dokument, ndërkohë që ne kemi çuar komplet diçka tjetër. Por, mbaro se do ta marr unë fjalën pastaj.

Znj. Eniana Koçiaj: Atëhëherë, se sot e paskeni marrë me shumë agresivitet, se po filluam edhe ne ana tjetër të mbajmë këtë qëndrim si ju nuk shkojmë asgjëkund.

Z. Altin Hazizaj: Po themi të vërtetat që s'para i themi.

Z. Vladimir Thano: Morëm guximin sot me 1 Prill.

Znj. Eniana Koçiaj: Përsa i përket problematikave të ngritura nga mbledhja e fundit, problematika e parë në mos gaboj kishte të bënte me qasjen jo bashkëpunuese ose edhe penalizuese që bankat e nivelit të dytë kanë me organizatat e shoqërisë civile si edhe me problematikën për regjistrimin e pronarit përfitues, pra që ishte një lloj penalizimi që kishte ardhur si rezultat i mosregjistrimit të pronarit përfitues në kohë - dhe problematika e dytë ishte regjistrimi i më shumë se një llogarie në të njëjtën monedhë, euro le të themi nëse përshembull, donatori ndërkombëtar mund të jetë dhe BE dhe GIZ-i atëherë kjo ishte një problematikë që kishit shprehur. Tani në lidhje me këto gjëra përgjigjia që erdhi nga Shoqata e Bankave, nga drejtoria juridike si dhe nga zonja Ada Qazolli na u tha që bankat praktikisht janë të detyruara që të zbatojnë një legjislacion shumë shumë strikt në lidhje me subjekte të cilat klasifikohen si subjekte me risk të lartë, dhe ato kanë penalizime shumë të larta në raste të tilla, dhe Ojft-kategorizohen si subjekte me risk të lartë në lidhje me pastrimin e parave, me terrorizimin e të tjera me rradhë. Bashkëngjitur me e-mail kishit normalisht të gjithë kuadrin rregullator dhe ligjor që janë detyrime që vijnë edhe nga BE. Pra, nuk bëhet fjalë sipas tyre vetëm për legjislacion vendas, porë dhe për kudër ligjor ndërkombëtar - pra kjo nuk është çështje vullneti por hapësire ligjore.

Z. Altin Hazizaj: Cili Bashkim Evropian?

Z. Vladimir Thano: E vazhdojmë të lutem se nuk dua te hyjmë në një pjesë tjetër të diskutimit.

Z. Altin Hazizaj: Jo, se do të pasqyrojmë dokumentat dhe nuk është Bashkimi Evropian që e kërkon. Është me e madhe kjo gjëja.

Z. Vladimir Thano: Eniana të lutem përfundoje sepse kemi pika të tjera në axhendë.

Znj. Fabiola Egro Laço: A mund të përgjigjem unë? Vetëm një përgjigje të shkurtër meqënëse më është kërkuar.

Z. Vladimir Thano: Jo, jo nuk mundeni sepse është jashtë axhendës së sotme.

Znj. Eniana Koçiaj: është përditësim mbi problematikat që ju keni ngritur. Ja ta mbaroj dhe këtë pjesën. Problematika tjetër që ishte hapja e më shumë se një llogarie në të njëjtën monedhë

- atëherë Banka e Shqipërisë nuk ka asnjë udhëzues që i ndalon bankat e nivelit të dytë për të hapur llogari, kjo nuk është e ndaluar. Por bankat, sipas tyre të paktën, nuk hasen shpesh me një praktikë të tillë sepse klientët janë përgjithësisht individë, biznese apo korporata e të tjera me rradhë të cilët kanë një kod unik identifikimi të lidhur për një llogari rrjedhëse, kështu që ata nuk janë hasur shpesh herë me këtë gjë dhe ka qenë një praktikë me të cilën na sugjeruan që ai manuali i BE që juve ju kërkon që të hapet një llogari për çdo projekt t'i kalohet shoqatës që ta vlerësojnë dhe ta shohin se çfarë mund të zgjidhin. Pra, u treguan shumë të gatshëm për të gjetur një zgjidhje të përbashkët që ata të kenë mundësi të ndjekin rregullat e tyre dhe ju gjithashtu manualin. Kjo ishte përgjigja zyrtare e shoqatës së bankave.

Z. Vladimir Thano: Fabiola një koment të lutem që të vijojmë më tej.

Znj. Fabiola Egro Laço: Një koment të vogël do të bëj. Nuk do të shteroj asgjë çfarë zoti Hazizaj dhe zoti Thano do të kenë për të diskutuar më pas. Unë sëpari dua ta falenderoj Enianën, si përfaqësuese e AMSHC-së që po i ndjek në bazë të kërkesave tona dhe ato çfarë janë diskutuar në takimin e mëparshëm e ka ndjekur deri në fund të problematikës. Tani, nuk është faji i Enianës nëse ata sjellin një manual të terrorizmit ku organizatat janë parë si burim terrorizmi, ndërkohë që në gjithë manualin shkruheshin të gjithë ato klauzola dhe gjithë ato pengesa për organizatat e shoqërisë civile, ndërkohë që bankat vetë na kanë futur në departamentin e korporatave, dhe nëqoftëse ne jemi apo trajtohem si korporata nëpër banka dhe paguajmë komisione dhe çdo gjë si korporata dhe pastaj kur është puna e ndalesave jemi organizata terroriste, atëherë këtu ka një problem, ka një qasje të gabuar. Në atë manual ne me aq sa mundëm sepse ishte e sjellë tani tek indikatorët e riskut manuali ishte copy-paste nuk e di se nga cili vend në të vërtetë organizatat mund të jenë një risk për terrorizmin, siç janë organizatat me bazë, ku di unë, fetare apo të tjera. Në manual të indikatorët e riskut thuhet se: pavarësisht faktit që në Shqipëri nuk janë materializuar raste të keqpërdorimit të ojf-ve dhe që ojf-të të jenë të rëndësishme për terrorizmin, pra që nuk ka raste të keqpërdorimit të ojf-ve për terrorizëm, por që janë të ndërgjegjshme të riskut potencial që kanë dhe nuk janë identifikuar elementë të cilat tregojnë që mund të jenë akuzuar. Për t'i ardhur në ndihmë sektorit të ojf-ve më poshtë paraqesim një sërë indikatorësh të cilët tregojnë që mund të ekspozohen, pra është e shkruar e bardhë mbi të zezë, që në Shqipëri nuk ka asnjë indikacion që organizatat e shoqërisë civile mund të kenë ndonjë rast risku të lartë. Kështuqë kjo nuk është një përgjigje.

Z. Vladimir Thano: Propozim atëherë, në axhendën e ardhshme, ne do të mund ta miratojmë në fund. Kam propozim që të thërritet Banka e Shqipërisë në kuadër të kësaj çështje, se këtu futet dhe pastrimi i parave, nuk është vetëm çështja anti-terrorizëm. Kështuqë kam bindjen që ne duhet të propozojmë që herës tjetër të kërkojmë Bankën e Shqipërisë. Zoti Hazizaj?

Z. Altin Hazizaj: Eniana, ne nuk kërkuam që të flasësh me një shoqatë, se po të jetë për shoqatë shkojmë e takojmë vetë nuk kemi nevojë për këtë tryezë. Ne kërkuam që në fillim që të vijë guvernatori ose dikush i caktuar nga guvernatori për të dhënë sqarime për pyetjet tona

dhe shqetësimet tona. Dhe shqetësimi ka të bëjë, unë falenderoj zonjën se ajo është treguar shumë e sinqertë, falenderoj qasjen e shoqatës së bankave sepse ne të pakëtn e kemi mundësinë që të shikojmë se çfarë shikojnë ata tek ne, është një mundësi shumë e mirë. Kjo më bën mua të kuptoj se të gjitha ato probleme që ne kemi çuar të përballemi me sektorin e bankave, qenkan dhe paskan të bëkan me një qasje sistematike, që ka të bëjë me një filozofi të ngritur, të ngulitur, të edukuar të të gjithë sistemit bankar në Shqipëri, gjë që ka të bëjë me Bankën e Shqipërisë. Pra, është autoriteti qëndror rregullator, kështu që në këtë aspekt unë i kërkoj të gjithë anëtarëve që Banka e Shqipërisë, në mbledhjen e ardhshme të jetë çështja numër një, duhet të vijë këtu patjetër, të caktojnë vetë përfaqësuesin, mund të vijë juristja, ata kanë shumë departamente në mënyrë që të gjitha shqetësimet që ne kemi me sektorin bankar t'i diskutojmë. Ka shumë shqetësime, ne do të përgatisim një letër të veçantë për t'i diskutuar, që normalisht dhe ata të vijë të informuar dhe të përgatitur. Besoj do të kemi kohë për këtë gjë.

Z. Vladimir Thano: Dakord, shkojmë me prezantimin e problematikave të hasura nga shoqëria civile.

Z. Altin Hazizaj: E miratojmë apo se miratojmë këtë njëherë përpara se të shkojmë te problematikat? A ka ndonjë që është kundër kësaj rekomandimi a kërkesë për mbledhjen e rradhës?

Z. Vladimir Thano: Jo, ok kaloi. Mirë, shkojmë në këto momente me prezantimin e problematikave të hasura nga shoqëria civile në kuadër të tkurrjes së burimeve financiare nga donatorët ndërkombëtarë. Përpara se të parashtroj pikërisht ato të cilat ne i kemi ndërmarrë jo vetëm kohëve të fundit por për shkak se jemi futur në një vit të ri, pra viti 2025 ku do të ketë dhe lëvizje të anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, është shumë e rëndësishme dhe ne e parapamë që të kishim një përmbledhje të problematikave të katër mbledhjeve të fundit. Kështuqë, më duhet të them se ne jemi të vetëdijshëm për dallimet që përcaktojnë shumë në lidhje me rolin që ne kemi, por ne duam të sjellim në Këshill atë që ne kemi vëzhguar, kemi evidentuar përgjatë mbledhjeve paraardhëse. Një nga problemet kyçe të cilat ne jemi ballafaquar është qëndrueshmëria dhe roli i institucioneve publike ne garantimin e demokracisë funksionale. Sigurimi i një mbështetje të vazhdueshme financiare dhe administrative për organizatat është thelbësore, jo vetëm për fuqizimin e sektorit, por edhe për përmbushjen e detyrimeve integruese të vendit në procesin e antarësimit në BE. Qendrueshmëria e organizatave të shoqërisë civile është një element jetik në forcimin e demokracisë dhe nxitjen e aktivizmit qytetar. Përgjegjësia sipas mendimit tonë nuk është as abstrakte dhe as simbolike, të gjithë kemi përgjegjësitë konkrete për të garantuar një jetë demokratike dhe gjithëpërfshirëse dhe për të krijuar mekanizma real mbështetës për organizatat e shoqërisë civile në tri fushat kryesore ku ne kontribuojmë. Më falni që po ju marr

pak kohë, qeverisja e mirë e të drejtave të njeriut, zhvillimi social, mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Një ndër çështjet kyçe që ne kemi prekur dhe duam ta vazhdojmë këtë bisedë është kuadri fiskal, sfida që barazon gabimisht shoqërinë civile me bizneset. Raporte ndërkombëtare përfshirë ato të BE dhe Agjencia e Bashkimit European për të Drejtat Themelore tregojnë se organizatat tona përballen me pengesa të mëdha fiskale. Trajtimi si subjekte tregtare, procedurat në sisteme bankare, që sapo i diskutuam, pasiguritë në regjistrat elektronik dhe përjashtimi jofunksional nga tvsh-ja, janë tashmë pengesë reale për jetën e përditshme të OSHC-ve. Nëse nuk adresohen këto çështje do të dobësojmë çdo mekanizëm tjetër mbështetës përfshirë dhe vetë oshc-të. Po të lexojmë mirë ligjin 119/2015 dhe rregulloren e Këshillit do të shohim se në strukturë në letër ne kemi një potencial që realisht mund të nxisë një bashkëpunim reflektues. Kështu e dashur Denada, edhe për mua sot mbyllet një rrugëtim 3 vjeçar, se ju keni qenë, kur e kam marrë rolin e nënkryetarit të këtij Këshilli. Kam patur fatin të jem për një periudhë të vështirë por domethënëse për këtë forum. Kemi ngritur zërin kur duhej, kemi bashkëpunuar kur kemi mundur dhe kemi kërkuar gjithnjë një rol tonin. Kështuqë dua t'iu falenderoj ju dhe Ministrinë që ju përfaqësoni, për energjinë dhe sinqeritetin në çdo mbledhje.

Problematikat që ne kemi shtruar në bazë të katër mbledhjeve të fundit janë qendrueshmëria financiare e oshc-ve dhe transparenca institucionale, prezantimi i të dhënave nga AMShC-ja në këtë mbledhje besoj ose në mbledhjen e ardhshme ne do ta kemi prezantimin e strukturës financiare sipas fushave që ka qënë një kërkesë e hershme kjo dhe e dakortësuar në mbledhjet e mëparëshme të Këshillit, përdorimi i platformës OPEN DATA për raportimet financiare publike ka qënë një pikë kyçe ku ish kryetarja zonja Manastirliu e ka përdorur si një shembull të mirë të asaj se çfarë mund të prodhojë ky Këshill në formësimin e kësaj politike, roli i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe oshc-ve në procesin e integritetit të Bashkimit European kemi propozuar që Kryenegociatori dhe Ministria të përgatisë një dokument politik të qartë për përfshirjen e shoqërisë civile në këtë proces.

Gjithashtu dua të bëj me dije dhe anëtarëve të Këshillit për rishikimin e ligjit numër 119/2015 për KKSHC. Është punuar një dokument dhe është dorëzuar nga ana e përfaqësuesit të OSBE-së në Shqipëri, përfshirë dhe shoqërinë civile në Ballkanin Perëndimor. Unë dhe sekretariati kemi qenë pjesë e disa tryezave diskutimi edhe jashtë Tiranës. Është bërë një punë shumë e mirë, pritet që dokumenti të validohet dhe të jetë pjesë e tryezës, por përpara se dokumenti të validohet do të ishte shumë shumë mirë që prezenca e OSBE-së ta ndante materialin, gjë që unë nuk e kam, dhe të kishte një pikëpamje më transparente të situatës.

Për përditësimin mbi hartimin e Udhërrëfyesit të shoqërisë civile nuk mbetet gjë tjetër përveçse asaj që ju shtuat por edhe të drejtorisë apo strukturës së re pranë Ministrisë. Qasja në sistemin bankar të oshc-ve është një pikë që e thamë por gjithashtu ligji për sponsorizimet, një ndër pikat kyçe që unë mendoj se duhet të punohet është miratimi i planit vjetor të aktiviteteve të komunikimit të KKShC-së.

Unë mendoj se shoqërisa civile është dhe mbetet një lëvizje e gjerë se ndoshta këtu jemi pak në vështirësi për shkak të ndryshimeve të politikave ndërkombëtare që e kanë rrudhur rolin e shoqërisë civile duke ju referuar edhe tërheqjes së USAID-it, por gjithashtu edhe disa shkresave por edhe dokumentave që kanë dalë aktorë të shoqërisë civile ku shprehin bindjen se në këto momente kush është roli i institucioneve publike përballë kësaj problematike dhe duke qënë se jemi në atë që quhet Proçesi i Integritimit Evropian shpesh herë mendohet se autoritetet publike nuk kanë detyrimin të mbështesin shoqërinë civile, por në fakt Integrimi i bën bashkëvendimmarrës në qënësimin politikave të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetarët. Kështuqë sipas mendimit tim, shoqëria civile mbetet një lëvizje e gjerë e ideve, e njerëzve, e lirive dhe e gjeneratave që vijnë përballë nesh. Unë ju falenderoj për këtë pjesë, këto janë problematikat reale që ne kemi dhe besoj që do t'i adresojmë dhe në mbledhjet e tjera.

Znj. Eniana Koçiaj: Në lidhje me studimin e OSBE-së për ndryshimin e ligjit, ata pothuajse janë në përfundim të studimit dhe sigurisht që na kanë lajmëruar se përpara se të dalë studimi do të bëjnë hapin e fundit që është takimi me të gjithë anëtarët e këtij Këshilli nga shoqëria civile. Do të bëhet takimi me ju dhe pastaj do të bëjnë publikimin, kjo sipas OSBE-së.

Z. Vladimir Thano: Po, dakort. Znj. Ermelinda?

Znj. Ermelinda Mahmutaj: Po, a do ta ndajnë me ne materialin e shkruar se ndoshta ne data e takimit të atyre mund të mos jemi të gjithë?

Znj. Eniana Koçiaj: Pasi të bëhet konsultimi me anëtarët e Këshillit do të nxjerrin materialin.

Z. Vladimir Thano: Dakord, shkojmë me pikën tjetër atëherë. Procesi integritetit të Shqipërisë në BE, roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë proçes, Znj. Evis Qaja, nga Ministria e Shtetit dhe Kryenegociatore. Fjala për ju.

Znj. Evis Qaja: Faleminderit zoti Thano, faleminderit zonja Seferi, dhe faleminderit të gjithëve ju, kolegë të nderuar.

Viti 2024 ka shënuar një përparim të jashtëzakonshëm në rrugëtimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke e pozicionuar vendin në një fazë të pakthyeshme të procesit të integritimit. Një nga momentet më kulmore ishte hapja e negociatave për Grupimin I “Themelorët” më 15 tetor 2024 në Konferencën e Dytë Ndërqeveritare në Luksemburg, dhe për Grupimin VI “Marrëdhëniet me Jashtë” më 17 dhjetor 2024 në Konferencën e Tretë Ndërqeveritare në Bruksel. Këto zhvillime përbëjnë një konfirmim të qartë të progresit të qëndrueshëm dhe përkushtimit të institucioneve shqiptare për përmbushjen e reformave kyçe të anëtarësimit, duke afruar gjithnjë e më shumë objektivin strategjik të integritimit të plotë në familjen evropiane.

Finalizimi dhe dorëzimi i Pozicioneve Negociuese për këto dy grupkapituj përfaqësojnë një hap thelbësor në përafrimin me acquis të BE-së dhe në konsolidimin e standardeve evropiane në Shqipëri. Për Grupimin I “Themelorët”, procesi nisi më 25 shtator 2024 me marrjen e kërkesës zyrtare nga Presidenca Hungareze e BE-së dhe vijoi me miratimin e draftit nga Grupi Negociator më 26 shtator 2024, shqyrtimin nga Kuvendi dhe më pas, miratimin përfundimtar nga Këshilli i Ministrave më 2 tetor 2024 (Vendimi nr. 614). Ky dokument thekson përkushtimin e vendit për një administratë të qëndrueshme, një sistem gjyqësor të pavarur, si dhe politika të avancuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pa kërkuar periudha tranzitore apo shmangie nga detyrimet e plota të acquis.

Në të njëjtën kohë, për Grupimi VI “Marrëdhëniet me Jashtë”, puna e institucioneve u intensifikua pas përfundimit të shqyrtimit analitik në nëntor 2023. Me kërkesën zyrtare të Presidencës Hungareze më 25 nëntor 2024, dokumenti u miratua fillimisht nga Grupi Negociator dhe më pas nga Kuvendi dhe Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian. Këshilli i Ministrave e miratoi atë më 4 dhjetor 2024, dhe vetëm pak ditë më pas, më 13 dhjetor 2024, BE miratoi Qëndrimin e Përbashkët, duke njohur përparimin e Shqipërisë dhe duke theksuar rëndësinë e vazhdimit të reformave në këtë fushë. Ky pozicion përcakton qartë angazhimin e Shqipërisë për harmonizimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë me atë të BE-së, përfshirë përputhjen me qëndrimet e Unionit në politikat tregtare, sanksionet, investimet dhe bashkëpunimin humanitar.

Me këto hapa, Shqipëria dëshmon vendosmërinë për të qenë pjesë aktive e arkitekturës politike dhe ekonomike të Evropës, duke synuar përmbylljen e suksesshme të reformave dhe anëtarësimin e plotë në BE deri në vitin 2030.

Struktura Kombëtare e Negociatave të Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, vitin e kaluar 2024, ka shënuar një intensifikim të mëtijshëm të punës së strukturave kombëtare dhe të negociatave, duke reflektuar një qasje të përshtetshme dhe të strukturuar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Përmes një koordinimi të ngushtë ndërmjet institucioneve dhe partnerëve, gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë hapa konkretë për të rritur performancën dhe efektivitetin e procesit të integritit.

Në 2024 janë zhvilluar 74 takime të Tryezave të Konsultimit të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian (PPIE), në të cilën janë përfshirë rreth 684 aktorë të grupeve të interesit, të kategorizuar në 7 kategori, më specifikisht 247 aktorë/grupeve të interesit si ekspertë të 36 fushave të acquis, 115 përfaqësues nga shoqëria civile, 206 përfaqësues nga academia/universitetet, 41 përfaqësues të komunitetit të biznesit, 56 përfaqësues të organizatave të pushtetit vendor, 2 përfaqësues të shoqatave të punëmarrësve dhe 17 përfaqësues të medias.

Ky mekanizëm ka mundësuar një bashkëpunim të frytshëm me partnerët ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe sektorin privat, duke garantuar transparencën dhe gjithëpërfshirjen në procesin e integritit. Me këtë qasje të strukturave dhe të qëndrueshme, viti 2024 ka shënuar një hap të rëndësishëm përpara në procesin e integritit evropian, duke e pozicionuar Shqipërinë më pranë objektivit të saj strategjik të anëtarësimit në BE.

Z. Vladimir Thano: Pikërisht, ajo që doja të thoja është fakti që të falenderoj shumë për prezencën por dhe gjithashtu rëndësia që ka Integritimi në Bashkimin Evropian në KKSHC ndaj do të ishte shumë e dobishme që edhe në mbledhjet e ardhshme ne të kishim disa segmente të caktuara të asaj që ne mendojmë apo bashkëmendojmë se janë shumë të rëndësishme për t'u trajtuar në Këshill. Në nivel agregati ju bëtë një prezantim i cili është shterues por na lejonin ndoshta dhe ta përpunojmë materialin dhe në nivel personal dhe në nivel dramaturgjik. Zoti Hazizaj?

Z. Altin Hazizaj: Faleminderit Ladi, unë kisha disa shqetësime që mendoj që është vendi i duhur për t'i shprehur. E para unë mendoj që gjithë ekipi negociator ka nevojë të kalojë përtej numrave. Numrat nuk do të thonë asgjë nëse nuk kanë rezultate. Unë nuk dëgjova ndonjë rezultat, qofsha unë i gabuar thjesht unë pashë shifra, përqindje që nuk më thonë asgjë. 74 takime mund të bëhen dhe 100 takime, dhe në ato takime është biseduar për asgjë, kohë e humbur kot. Ajo që ka rëndësi, që të mos e bëj më dramatike seç ishte, është që ne të marrim disa rezultate. Pra, gjithë ato takime, nuk kam asnjë paragjykim, ne marrim vetë pjesë në ato

tryeza konsultative, të dimë se çfarë rezultatesh ka, sa ka ndikuar, sa janë marrë parasysh pra ky është rezultat. Tani, e dyta që unë e kam një shqetësim, janë disa çështje që kanë të bëjnë me pozicionin negociues. Pozicioni negociues të paktën për themeloret nuk u bë asnjëherë publik, ne e kemi marrë nga faqja, në mos gaboj ka qënë austriake. Dmth aty ishte pozicioni negociator i Shqipërisë bashkë me pozicionin negociator të Austrisë, që nuk bën sens, që do të thotë që për më tepër pozicioni negociues nuk u konsultua, gjë që tregon për mendimin tim një mungesë të dialogut. Është ngritur si shqetësim, në mos gaboj kemi qënë disa, të paktën ne që jemi në procesin e negocimit, është ngritur si shqetësim dhe duhet një reagim. E njëjta gjë është përsa i përket pozicionit të negocimit të kapitujve të tjerë apo më saktë të grupkapitujve, ato do të duhet të konsultohen, nëse ka opinione mirë, nëse nuk ka s'ka dhe unë shpresoj që të mos ketë por ideja është që të gjithë të marrim pjesë dhe të kryejnë atë rol. Një gjë tjetër që unë e kam me shqetësim, nëqoftëse gjithë kapitujt e kanë siç thoni ju, 33 tryeza, 36 në total e kanë nga një lider të kapitullit dhe në një tryezë konsultuese është e hapur, ju vetë nuk keni një tryezë tuajën konsultimi me shoqërinë civile. Si konsultoheni ju me shoqërinë civile apo e bëni kështu në mënyrë indirekte kur i thonë bjeri derës të degjojë deriçka, kështu vete muhabeti. Unë dua të di vetë Ministria si konsultohet dhe vetë Kryenegociatorja si konsultohet?

Z. Altin Hazizaj: Ju s'keni vetë në mënyrë direkte dialog me shoqërinë civile dhe mendoj se kjo duhet të zgjidhet.

Z. Indrit Seferi: Ne njiheshim me prezantimin që u bë, dhe do të doja të pyesja pak a shumë dhe për pjesën e zyrës që do të ngrihet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale që do të bënte koordinimin midis komunikimit të shoqërisë civile të paktën te profili i shëndetësisë, a do të jetë e njëjta gjë në të gjithë ministrinë, sepse mendoj se të paktën që kur kam marrë mandatin unë e kam hedhur si ide sepse do ishte shumë facilituese e para dhe për ju të gjithë ministrinë e linjave që janë përkatësisht dhe nga ana jonë që jemi në Këshill si përfaqësues i shoqërisë civile por edhe oshc-ve të tjera që kanë nevojë të informohen. Mendoj që ndodh shpesh mosinformimi i duhur dhe në kohë reale dhe mos le të themi ndarje e informacionit shpesh na çon në konflikte, shpeshherë duke bërë punë por duke mos u evidentuar punët. Pra, qoftë dhe nga ana jonë e shoqërisë civile, qoftë dhe nga ana juaj e ministrisë, ne këtu patjetër jemi partner por nëqoftëse ne nuk lidhim urat në mënyrën e duhur, kanalizojmë informacionin nëpërmjet AMSHC-së, pra dhe ju të komunikoni apo këto informacione t'i bëni me dije në sekretariatit e KKSHC-së në AMSHC. Mendoj se duhen ato zyrat, pra një person që merret me këtë pjesë dhe nuk e di a e kanë në plan?

Znj. Ermelinda Mahmutaj: Zonja Evis, shumë faleminderit për prezantimin, unë në fakt nga të gjitha ato çfarë ju thatë do të vlerësoja dy nga rezultatet dhe mendoj që janë të rëndësishme

të paktën në këndvështrimin e punës tonë që është pjesëmarrja e shoqërisë civile në tryeza dhe përfshirja e komenteve dhe e kontributeve të tyre. Unë mendoj që këto dy rezultate sikurse në secilën pjesë apo tryezë të jenë të përfshira kontribuojnë në rezultatin e përbashkët që është avancimi i axhendës të integritit. Kështu që faleminderit, pyetja ime në fakt lidhet me rolin e KKSHC sepse ndoshta duhet bërë një ndërhyrje fare e shkurtër si organizatat e shoqërisë civile kanë filluar ta udhëheqin dhe ta drejtojnë axhendën e tyre brenda këtij Këshilli. Ajo udhëhiqet nga një Takim Kombëtar që kemi bërë me shoqërinë civile në 2023 në të cilin kemi identifikuar 7 sektorë shumë të rëndësishëm për fuqizimin dhe rritjen e rolit të sektorit. Dhe ne punojmë mbi to, një ndër to është fisku, një prej të cilave është dhe Integrimi Evropian. Pavarësisht se secili institucion qeveritar ka axhendën e vet të përfshirjes dhe të konsultimit me shoqërinë civile pyetja ime është, si e shikoni ju rolin me KKSHC-në, në një nga takimet tona ne kemi diskutuar që Këshilli mund të luajë një rol shumë të fuqishëm apo të jetë një aleat i të gjitha institucioneve e procesit në kuadër të Integritit. Pra, si na shikoni ju si KKSHC dhe jo vetëm si sektori i shoqërisë civile? Pra, si mund të kontribuojmë ne ekstra në këtë proces?

Znj. Fabiola Egro Laçi: Fjalja e fundit sepse ne e diskutuam së bashku me Ermelindën, fjalja e fundit është një sugjerim. Duke falenderuar përsëri zonjën Evis, për të gjithë parashtrimin që bëri dhe që ishte shumë i plotë, ishte pambarimisht dhe nuk mund të shteronte në këtë mbledhje, sugjerimi im është që meqë zonja Evis gjatë gjithë paraqitjes së saj ka thënë që anëtarët e shoqërisë civile janë pjesë, janë pjesë integrale e takimeve, e gjithë fushave e të tjera, a mund ta shihini ju si një partner dialogu me shoqërinë civile ku Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile të këtë një pozicion të veçantë dhe të jetë pjesë në ato kritere që ju keni përzgjedhur? Ne këtu të gjithë jemi të zgjedhur, të votuar dhe jo të emëruar, pra flas për pjesën e shoqërisë civile, duke qënë se jemi të zgjedhur atëherë të gjithë ne përfaqësojmë një grup shumë të madh të shoqërisë civile dhe duke ju kthyer Ermelindës, kemi qënë ne ato që kemi bërë këtë Konferencë duke e pasur këtë Konferencë me shumë anëtarë rreth 99 organizata të shoqërisë civile për të ngritur dhe një herë probleme dhe për të nxjerrë rekomandime që ne do i drejtoheshim dhe do të bënim dialog dhe do të gjenim përgjigje nga qeveria nga anëtarët e qeverisë.

Znj. Evis Qaja: Një nga indikatorët kryesorë të matjes së efikasitetit është reagueshmëria, e cila reflektohet në punën e Tryezave Konsultuese. Në vitin 2024 zhvilluar 74 takime, ku kanë marrë pjesë 684 aktorë të grupeve të interesit, çka tregon për një angazhim të qëndrueshëm dhe bashkëpunues në proces.

Një tjetër tregues i rëndësishëm është pjesëmarrja. Edhe pse shpesh e konsiderojmë të mirëqenë, në realitet pjesëmarrja e qëndrueshme kërkon ndërtimin e një dialogu besimi. Anëtarët e Tryezave të Konsultimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian

(PPIE) nuk janë aty si individë, por si përfaqësues të përzgjedhur nga organizatat që i kanë mandatuar. Kjo kërkon kohë, strukturë dhe ndërtim besimi hap pas hapi. Dhe rezultatin përpiqemi ta matim me çfarë kontribuon realisht në produkt.

Znj. Denada Seferi: Mund të shtoj diçka, në vijim të asaj çka Evisi tha, duke qenë edhe në pozicionin e Negociatorit, ne kemi grupe pune ndër-institucionale të integritetit evropian që janë pjesë e platformave të integritetit, ne për ato produktet që Evisi thotë janë pjesë e çdo ministrie të linjës, pra për çdo kapitull që kemi, psh për kap. 19 punësimi e ka të përbashkët me ne sikurse edhe ne e kemi të përbashkët me çështje që lidhen me punësimin si për shembull pjesa e ndihmës ekonomike, asistencës për personat me aftësi të kufizuara etj. Dhe këtu ka grupe intersi të cilat përfshihen në këto diskutime. Pra nëse ne do të duam që ta fusim KKSHC në këto diskutime, ai do duhet të futet si një organ, si një instrument që përdoret. Por ndërkohë KKSHC nuk mund të zëvendësojë grupet e interesit apo ato organizata që janë pjesë e këtyrë GNPIE-ve që janë në fakt pjesë integrale e tyre sepse preken në mënyrë të drejtpërdrejtë çështje interesi të tyre siç janë psh personat me aftësi të kufizuara. Kshuqë nëse kërkohet, duhet të kërkohet në këtë prizëm pjesa e Këshillit, por GNPIE-të do të funksionojnë si platforma integriteti në mënyrë që të jenë gjithëpërfshirëse.

Z. Altin Hazizaj: Pra duhet që KKSHC të ketë një rol më direkt në këtë proces.

Z. Vladimir Thano: Nga këto 74 tryeza pra si ndahet informacioni dhe si bëhet i aksesueshëm tek publiku ky informacion?

Znj. Evis Qaja: Tryezat Konsultative të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) funksionojnë përmes anëtarëve permanentë dhe zëvendësues, sipas një kalendari të integruar pune që u shpërndahet anëtarëve që në fillim të vitit. Ata marrin pjesë aktivisht në bashkëkrijimin e propozimeve të tematikave që trajtohen gjatë vitit. Procesi parashikon gjithashtu një qasje fleksibile, duke mundësuar shtimin, heqjen apo riformulimin e çështjeve në rendin e ditës, bazuar në zhvillimet dhe interesin e momentit. Tryezat kanë ngritur standarde dhe procedura të qarta pune me aktorët e grupeve të interesit, duke garantuar një proces të dokumentuar. Diskutimet protokollohen, ecuria monitorohet, dhe përmes argumentimeve specifike sqarohet se cilat komente përfshihen në dokumente përfundimtare dhe cilat mbeten për t'u trajtuar në takime të tjera.

Z. Vladimir Thano: Vazhdojmë me pikën tjetër në Axhendë që është **Efikasiteti i Ligjit për Sponsorizimet** – një çështje e ngritur prej kohësh me të drejtë nga shoqëria civile. Z. Hazizaj ju lutem.

Z. Altin Hazizaj: Unë nuk kam as prezantim në fakt dhe nuk dua të ndalem vetëm tek ligji për Sponsorizimet, por dua të ndalem **tek gjithë kuadri rregullator legjislativ për shoqërinë civile**. Bëhet fjalë për disa ligje, e para që në mbledhjen e parë të KKSHC –së, këtu e goxha

kohë përpara as unë nuk e mbaj mend tani, kemi lënë të hapur një diskutim dhe nuk kemi marrë asnjë vendim në lidhje me Projektligjin për Financimin e OJF-ve. Shqipëria mund të jetë vendi i vetëm në Evropë që nuk ka ligj të posaçëm për financimin e sektorit të shoqërisë civile. Në atë kohë unë kam pasur punuar me Irisin më duket që ka qenë në grup me mua – bëmë një miniprodukt që e konsultuam me shoqërinë civile. Ajo që dua të sjell është se janë tre propozime. Ky është një propozim për ligj të ri Ligji për Sponsorizimet ka pësuar një ndryshim në mos gaboj pas 2008-ës, ku i është bërë një ndryshim sia të cilit sponsorizimet merren në konsideratë nga biznesi vetëm për aktivitete kulturore dhe sportive. Dhe shoqëria civile është hequr në mënyrë të padrejtë nga përfitimi i sponsorizimeve, pra nga kompanitë që mundet ose do të donin të financonin një aktivitet të organizuar nga shoqëria civile, jo se i pengon kush por nuk marrin përfitimet që i njeh Ligji i Sponsorizimeve. Në këtë kaudër rekomandimi jonë është që të rishikohet si Ligj, dhe po në këtë kuadër meqenëse ligji ka të bëjë edhe me OJF-të, unë do doja që të marr konfirmimin tuaj që një grup nga ana e shoqërisë civile pra nga KKSHC të diskutojë për këto nisma të konsultohemi me shoqërinë civile e më pas të vinë me propozime konkrete në këtë Këshill për 2-3 ligje por mund të dalin edhe propozime gjatë rrugës se ne për shembull vazhdojmë të themi që çështja e fiskut është ende e pazgjidhur dhe jam i sigurtë që edhe në procesin e negociatave besoj ka dalë kjo problematikë, në raporte ka dalë e vazhdon të dalë – prandaj mund të ketë edhe një propozim të katërt sa i përket çështjes së fiskut. Dua paraprakisht një miratim nga ju, pra a e autorizoni që të sjellim propozime ligjore në këto 3-4 aspekte që unë përmenda? Unë propozoj të krijojmë një grup pune që është i hapur për të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile për të diskutuar aspektet ligjore të mbështetjes dhe mjedisit mundësues për ojf-të ku përfshihen Projektligjet për sponsorizimet, për financimet e OJF-ve dhe ligji tjetër aktual për Fiskun. Grupin e punës pastaj e diskutojmë mes nesh me konsultim me shoqërinë civile meqenëse është nismë që vjen nga shoqëria civile.

Z. Vladimir Thano: Faleminderit Altin, a jeni dakort me propozimin e z. Hazizaj?

Znj.Ermelinda Mahmutaj: Kemi nevojë për pak më shumë sqarime a mund të shtyjme për mbledhjen tjetër? Pra si tema jemi patjetër dakort, por flas për mënyrën se si do të përqaset.

Z. Altin Hazizaj: Modalitet i vendosim më vonë, i diskutojmë ne si shoqëri civile. Pra miratohet në parim, dhe pjesën tjetër e diskutojmë. **Miratuam që ne si shoqëri civile të punojmë mbi rishikimin e bazës ligjore që ka të bëjë me OJF-të në Shqipëri.**

Z. Vladimir Thano: Po jemi parimisht dakort. Shkojmë tek prezantimet në lidhje me **mbështetjen financiare për shoqërinë civile**, e kemi kërkuar këtë prezantim për të vetmen arsye se është një dëryrim jo vetëm ligjor për Këshillin, por duam të dimë dhe të kemi një qasje çfarë janë programe sturkturore në nivle institucional dhe kush janë programet që mbështesin e shoqërisë civile. Do shkojmë më prezantimin nga Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve, Znj.Topçiu.

Znj.Arlinda Topçiu: Faleminderit Z. Thano, faleminderit të gjithë kolegëve për kontributet me kaq vlerë, ç'është e vërteta shoqëria civile është pjesë integrale dhe partner kyç i punës së përditshme të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Në saj të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, Ministria me portofolin e saj pak “modest” realizon edhe thirrje të hapura për shoqërinë civile, konkretisht për organizatat për të rinj dhe organizatat rinore për të cilat ka edhe një specifikim ligjor në Ligjin për Rininë, që përcakton çfarë kriteresh duhet të kenë për t'u klasifikuar si të tilla.

Ne hapim thirrje të përvitshme qoftë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat janë fonde infrastrukture, nuk po flasim sot për këtë pjesë. Hapim gjithashtu edhe fonde që lidhen me rritjen e aftësive dhe mbështetjen e shoqërisë civile dhe të rinjve që janë përfituesit përfundimtarë të thirrjes. Deri tani numërojmë katër thirrje të hapura nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ndërkohë që jemi edhe në prag të hapjes së thirrjes së pestë. Ne përcaktojmë edhe disa prioritete për fushat që hapim thirrjet. Prioritet bazohen kryesisht në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, e cila ka edhe shtyllat kryesore. Dokumenti i dytë ku bazohemi është një vlerësimi i situatës së të rinjve, dhe pika e tretë është edhe analiza e thirrjeve të mëparshme nga të cilat ne identifikojmë boshllëqe dhe kuptojmë që duhet të ketë një alokim ndryshe të fondeve. Tre fushat kryesore të përparësisë, të cilat jemi përpjekur të jenë sa më të gjera që të mund të pranojmë sa më shumë projekt-propozime të shoqërisë civile, pra të shmanget pjesa që hedh poshtë projekt-propozime të cilat nuk përputhen me fushën. Nëse më lejoni shumë shkurt një përshkrim i prioriteteve:

Prioriteti i parë ka të bëjë me fuqizimin e të rinjve dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën qytetare ekonomike qoftë në nivel lokal aashtu edhe në atë qendror, këtu përfshihet gjithashtu edhe pjesëmarrja në qendrat rinore, pjesëmarrja në proceset demokratike që zhvillohen në nivel qendror ose vendor, fuqizimi i KVR-ve. Fusha e **dytë** ka të bëjë me shumë me punësimin dhe ndërlidhjen e të rinjve në tregun e punës dhe pjesën e edukimit. Këtu janë një sërë iniciativash duke filluar nga këshillimi i karrierës, nxitja e aftësive sipërmarrësve, nxitja e aftësive të komunikimit, leadership-it, negocimit për të rinjtë. Dhe prioriteti i **tretë** ka të bëjë me rritjen e mirëqënies kulturore, sociale dhe sportive të të rinjve ku këtu fusha është shumë e gjerë, duke filluar nga aspektet e jetës shëndetësore e të rinjve e deri tek impakti që aktivitete kulturore dhe sportive mund të kenë në jetën e të rinjve, të cilat rrisin mirëqënien apo ndërveprimin social të të rinjve në komunitete e tyre.

Në thirrjen e katërt, pra në atë paraardhëse, janë mbështetur **26 organizata** të shoqëriës civile. Mbështetja ka qenë me një **fond** total prej **70.000.000 lekë të reja** dhe ka dy transhe, dy kategori në të cilat ne financojmë organizatat e shoqërisë civile: Organizatat rinore deri në 1.5 milion lekë të reja, ndërkohë organizatat për të rinjtë deri në 3.5 milion lekë të reja. Brenda këtoj kuadri, ne kemi marrë dhe përshtatur metodologjinë ReLoad, e cila është marrë nga UNDP dhe është një metodologji që garanton transparencë, pjesëmarrje sikurse u jep edhe fondeve të donatorëve të huaj të bashkojnë fondet me buxhetin e shtetit që të shtohet edhe baza financiare për organizatat. Kjo metodologji është adoptuar që në vitin 2022, dhe ne

pretendojmë që në thirrjen e pestë të japim jo vetëm fonde nga buxheti i shtetit të cilat të jenë minimalisht sa shuma që është alokuar një vit më parë, por të kemi edhe një rritje të lehtë të mbështetjes që vjen në kuadër të programit EU for Youth e cila ka edhe aty një komponent, një shtyllë në kuadër të arritjes së të rinjve, konkretisht të kategorisë NEET. Në momentin që ndodh ky lloj bashkimi, do dilet edhe me një prioritet të katërt që ka të bëjë me adresimin e kësaj nevojë. Janë realizuar gjithashtu shumë sesione informuese, qoftë online qoftë fizikisht, me Agjensinë e Rinisë është proces që qëndron i hapur për rreth 30 ditë rresht ku organizatat aplikojnë - çdo pyetje, ankesë u përgjigjemi sipas procedurave përkatëse. Mirëpresim aplikime, mirëkuptojmë që ka shumë nevojë nga organizatat e shoqërisë civile, dhe përpiqemi që përzgjedhja të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe e drejtë.

Znj. Ermelinda Mahmutaj: A mund të na shpjegosh pak të lutem edhe mekanizmin e funksionimit që na intereson edhe ne në afatgjatë. Cili është mekanizmi i Ministrisë, pra a ka një drejtori pranë Agjensisë që e mbështet në afatgjatë shoqërinë civile apo mekanizmi i dedikohet më shumë targetit se sa shoqërisë civile?

Z. Vladimir Thano: Duke patur parasysh se një ndër problemet që lidhet me organizatat e shoqërisë civile, nëse i dnajmë organizatat senjore, që kanë vite dhe rinore. Është krejtësisht e pamundur me këtë kaudër fiskal ekzistues që të mbijetojnë shoqatat e reja – jam dakort me tematikat por se si mund t’ja dali një organizatë që të jetë vetëm tematike dhe ka problem të stabilitetit. Mos harroni se disa 18-vjeçarë hapin OJQ futen në sitem fiskal me NIPT etj dhe në fund ne gjenerojmë shumë organizata të cilat sot janë pasive, me borxhe kundrejt institucioneve tatimore. Këtë problematikë e kemi shtruar edhe në mbledhjet e mëparshme që duhet një amnisti fiskale për organizatat dhe në xhepat e këtyre të rinjve si organizatat European Youth Partner që janë hapur 5 herë sepse ka problem të funksionaliteti pra. Si i përgjigjet një Ministri për Rininë një problematike që sot jemi pak adult, por dua të kuptoj se si fëmijët që do rriten do bëhen pjesë aktive e shoqërisë civile? Se kjo është një gjë shumë e rëndësishme për të garantuar zinxhirin – jo si puna e gjethit që nuk po e gjemë më.

Znj. Arlinda Topçiu: Faleminderit shumë për pyetjet. Po e filloj me pyetjen e parë të Znj. Mahmutaj në lidhje me mekanizmin. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është një Ministri pa portofol, pra nuk ka një buxhet dhe as një zë buxhetor në buxhetin e shtetit. Ne kemi një institucion varësie që është Agjencia Kombëtare e Rinisë e cila ka edhe zërat përkatës buxhetor, ku një zë është i dedikuar për thirrjet. Pra në saj të këtij zëri që ka një alokim fondi “X” të caktuar, që për hir të së vërtetës ka një rritje të lehtë vit pas viti në saj të lobimit që ne kemi bërë në Ministri të Financave dhe nevojave që ka, dhe ky zë është i atashuar për shoqërinë civile. Konsultohet ky lloj zëri edhe me Këshillin Kombëtar të Rinisë, i cili është një organ konsultativ si i juaji, pranë Ministrit përgjegjës për rininë, përcaktohen e vulosen prioritetet, sillen komentet nga shoqëria civile, përcaktohet edhe shuma dhe hapet thirrja. Thirrja menaxhohet nga pikëpamja teknike nga Agjensia e Rinisë, por vlerësimi bëhet nga një komision ad-hoc, që ka përfaqësi qoftë nga Ministria jonë, qoftë nga AKR, nga shoqëria civile, apo edhe nga një donator që kontribuon. Në këtë lloj konteksti menaxhohet si një organ i

pavarur thirrja, nga ky lloj mekanizmi i ri i ngritur dalin rezultatet të cilat miratohen sipas procedurave përkatëse nga Ministri i linjës.

Znj. Ermelinda Mahmutaj: Pra Agjencia e ka në mandatin e saj mbështetjen e shoqërisë civile rinore, dhe ka një buxhet të dedikuar tematik?

Znj. Arlinda Topçiu: Po kjo është mënyra si jepet mbështetja. Siç ka edhe një fond të dedikuar për pushtetin vendor fondi nr.231 që është “llaç dhe tulla”, pra infrastrukturë, ashtu ka edhe një fond të dedikuar për shoqërinë civile i cili është një zë i butë me bazë vjetore dhe duhet të shpenzohet për një kohë prej 12 muaj.

Znj. Arlinda Topçiu: Po është e vërtetë, shumë faleminderit Evis, është e programuar në PBA, e cila miratohet në Ligjin e Buxhetit të çdo viti. Ndërkohë në lidhje me pyetjen e Z. Thanos, po është shumë e vërtetë kjo që thoni ju, dhe është problem real kalimi i shumë organizatave në status pasiv. Ai mekanizmi jonë që ne i japim një mundësi deri në 1.5 milion lekë një organizate bërthamë të sapokrijuar kjo nuk do të thotë që ajo do ngelet bërthamë gjithë kohës. Por mbas një viti apo dy, pasi të fitojë një eksperiencë të caktuar, të mund të marrë edhe 3.5 milion lekë fonde për shembull. Në këto 3-4 vite që ne kemi eksperiencë, ndoshta Indriti (Seferi) më mbështet, një organizatë e studentëve të mjekësisë e cila ka filluar si celulë në Universitet me kalimin e kohës ka kaluar në organizatë rinore. Dhe kjo nuk është inisiativa e vetme që ka Ministria, me kalimin e Ligjit të ri, me rishikimin e ligjit që e kaluam në 17 mars 2025, është parashikuar një mbështetje e re për grupe joformale, KVR, apo struktura të tjera, që të rinjtë një ide që kanë ta implementojnë pastaj me konsolidimin e tyre të kalojnë në faza të tjera.

Z. Vladimir Thanos: Në rregull faleminderit – sepse duhet thënë që nuk mund t’ja lëmë AMSHC-së barrën e vetme, që në fakt e ka të rëndë. Kalojmë tek Ministria tjetër.

Z. Sofjan Jaupaj: Përshëndetje, unë përfaqësoj Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, e cila në fushën e turizmit fiancon organizata jofitimprurëse me thirrje dy herë në vit. Qasja është për të financuar aktivitete të turizmit kulturor, kulinar, sportiv, të ekoturizmit dhe argëtimit në mënyrë që qeveria të ketë kalendarin turistik, për shkak se turizmi është sektori i dytë i ekonomisë në vend, pas bujqësisë. Çdo janar dhe shtator hapen thirrje nga Ministria për mbështetje financiare. Qasja për thirrjet është pak a shumë e njëjtë si ajo që u prezantua nga MEKI pasi projektet që miratohen nga MEKI dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bashkohen dhe krijohet kalendari turistik i vendit, që është një element shtesë që u ofrohet turistëve përpos vizitueshmërisë që ata bëjnë në Republikën e Shqipërisë. Vlerat financiare të përvitshme variojnë nga 1.5 milion euro në 2 milion euro, qasja jonë ka qenë gjeneraliste. Ne, që nga 2023 kemi thjeshtuar të gjitha kriteret për aplikim. Nëse më parë kërkohej që aplikimi të ishte me bashkëfinancim të huaj, financim nga private etj. Ne i kemi hequr – pra mbështetja financiare që japim shkon në 100%. Kriteret ligjore dhe teknike janë bazike në mënyrë që të mos ketë pengesa administrative kur ideja është e bukur, sepse për ne e rëndësishme është që produkti të jetë interesant, pra që ka të bëjë me vizualitetin, targetin meqenëse po flasim për

një element vizual dhe vizitueshmëri. Zakonisht kemi nga 35 deri në 60 aplikime të suksesshme të cilat fianncohen, duke përmendur këtu kryesisht organizatat kulturore të cilat në fakt ndahen. Një pjesë fianncohet nga MEKI dhe pjesa tjetër nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ka qenë një proces i sukseshëm, akoma më i sukseshëm këto dy vitet e fundit pas thjeshtimit të procedurave administrative sepse normalisht edhe disbursimi financiar është më i lehtë për t'u kryer nga ne në momentin që nuk kërkohen 100 dokumenta shtesë nga ana jonë. Ndërsa për fushën e mjedisit, Ministria nuk ka një fond të dedikuar për organizatat jofitimprurëse, por ne kemi një tjetër qasje për këtë sektor. Aktualisht që flasim mbështetja financiare për asistencë teknike për Republikën e Shqipërisë, është në nivelin me të lartë historike që ka qenë ndonjëherë, kështuqë të gjitha organizatat jofitimprurëse në fushën e mjedisit janë të angazhuara në projekte.

Ministria është promotore dhe hartuese e programeve, por qasja jonë tani është që një pjesë të mirë të organizatave të mjedisit ne t'i kthejmë në atë që ju thatë më përpara në organizata "senior", kjo sepse problematika jonë kryesore ka të bëjë me faktin që ne si Ministri kemi një qasje kundër përdorimit të interlokutorëve për aplikimin e fondeve të huaja që janë në Shqipëri. Pra qasja është e tillë, ne hartojmë dhe propozojmë një program, miratohet nga Komisioni Evropian, dhe Delegacioni vendos të ketë një interlokutor siç mund të jetë GIZ-i, UNDP të cilët duhet të kontraktjnë organizata jofitimprurëse shqiptare. Lufta që duhet të kemi ne të gjithë, por edhe Këshilli Kombëtar mendoj unë, është që të largojmë interlokutorët, sepse pas 3 vitesh në momentin që fondet e kohezionit që do jenë të hapura për Shqipërinë, nuk do jenë më këta interlokutorët të cilët do duhet të marrin këto financime. Ne kemi zhvilluar në mënyrë të suskeshme me disa fonde të mjedisit siç është "Green Climate Fund" apo Global Environmental Facility ku i kemi hequr interlokutorët dhe kanë dalë organizata të suksesshme vendase të cilat kanë përfituar edhe projekte deri në 5 milion euro e më lart – prandaj unë sugjeroj që kjo duhet të jetë edhe një temë diskutimi që duhet ngritur në këtë Këshill. Duke patur parasysh edhe afatin që Evisi tha pak më parë që kur ne mendojmë të përfundojmë me negociatat, kur mendojmë të kemi një dritë jeshile edhe për fondet e kohezionit ne duhet të jemi të përgatitur. Unë kam më shumë merakun e organizatave "senior" se sa ato "junior", sepse junior do bëjnë rrugën e tyre, do kalojnë ciklin e zhvillimit, se jemi në ekonomi tregu, por ama mendoj se ata të cilët janë interlokutorë duhet të fillojnë që të tkurren e të largohen në momentin që ne të bëhemi vend anëtar.

Znj.Denada Seferi: A mund ta vazhdoj pak këtu ku e la Z. Jaupaj. Ne do të na duhet që edhe të krijojmë klimën dhe qasjen e duhur që duhet të kenë organizatat për përthithjen e këtyre fondeve, sepse bëhet shumë e vështirë për sa i përket disa kritereve të cilat shpeshherë mund të jenë penalizuese por edhe favorizuese për disa të tjera. Pra në të dyja prizmet shihet që ke ose kufizime ose favorizime. Ideja është se sa do të mund ne përtej kritereve të cilat i vendosin ata që hapin thirrjen në kuptimin e barazisë, transparencës, gjithëpërfshirje etj etj – pra sa mund ta bëjmë ne gati mjedisin tonë me OJF që ata të përthithin fonde, të kenë sesione informimi trajnimi ndërgjegjësimi?

Z. Sofjan Jaupaj: Unë personalisht mendoj se programi që Shqipëria aderon, por edhe nëpërmjet sesioneve të informimit, duhet të jenë një target i mirë edhe për organizatat që të ushtrohen. Kemi për shembull programe si “Creative Europe” apo “Europe4Citizens” ku jo vetëm orgaizata por edhe nëjsitë e vetëqeverisjes vendore të cilat janë përgjegjëse për 70% të *acqui*-s që duhet të zbatojnë duhet që të jenë të përgatitura që të përthithin fonde, sepse problemi jonë do të jenë kapacitetet për të përthithur fonde, pra çështja është që të jenë organizatat shqiptare ato të cilat zbatojnë projektin nga A-ja te Zh-ja dhe të mos marrin thjesht një kontratë ekspertize. Dhe kjo ndodhi edhe me Kroacinë në 2013, e prandaj ne kemi një dritare 4-5 vjeçare deri në 2030 që të adaptohemi, edhe organizatat jofitimprurëse të shkojnë edhe më “senior” seç janë në numër punonjësish, sepse në momentin që merren kontrata të mëdha, normalisht rritet portofoli, kapacitetet.

Z. Vladimir Thano: Dhe besoj se edhe puna e sekretariatit është që të dalim me këto pika sepse na thonë që nuk i publikoni, procesverbalet janë të gjata etj. Shkojmë me Z. Greva.

Z. Albi Greva: Kam shumë kënaqësi që po shihem me disa prej jush që kam punuar shumë më herët, që nga viti 1994, në kohën e UNDP-së. Për ata që s’më njohin kam punuar për një kohë shumë të gjatë në biznes, deri në 14 vjet në kompaninë Vodafone, por edhe aty kam patur rolin e financimit të projekteve sociale. Jam aq i ri sa është edhe pjesa e Inovacionit tek Ministria e MEKI-t, pra i jam bashkuar stafit të Ministrisë në muajin shtator 2024. Në lidhje me pikën që i referohem përveç një prezantimi të shkurtër të financimeve që janë kryer, do të doja të shtoja pak më shumë edhe sa i përket angazhimeve, sepse nuk është vetëm financa ajo që simbolizon pjesën e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndaj shoqërisë civile.

Pjesa më e stabiluar ndër vite tek Ministria jonë ka qenë pjesa e **artit dhe kulturës**, dhe i përgjigjet thirrjeve periodike vjetore, që i përkohet njoftimit publik në dhjetor të 2024. Tani jemi në fazën që sapo janë shpallur, ndoshta ju jeni gia të informuar nga mjetet e komunikimit. Bëhet fjalë për **275 projekte fituese për një total prej 30 million lekësh për vitin 2025**. Kjo shumë shënon edhe një rritje prej 20% sa i përket numrit të projekteve, ndërkohë shuma është 2.5 herë më e madhe se vitin e kaluar. Ndërsa si impakt i pritshëm i gjithë kësaj është punësimi në këtë aktivitet i afërsisht 1600 punonjësish që do të kryejnë punë përgjatë këtij viti – këto si të dhëna kryesore. Dhe një e treta e fondeve janë për krijimtarinë dhe artizanatin, ndërsa pjesa tjetër për art dhe kulturë. Nuk kam hyrë në detaje të tjera por janë të gjitha të dhëna publike të cilat mund t’i eksploronë në kohë.

Sa i përket **Inovacionit**, siç e nisa është një strukturë e re, është një pjesë e re e cila për herë të parë në Shqipëri u fut në kuadrin e një Ministrie – kshuqë pjesa më e madhe e asaj që do të flas në këtë pikë është bashkëpunimi me donatorët, duke qenë se edhe Ministria kur u krijua nuk kishte një buxhet përkatës që të mund të flitej për impakte apo strategji të shkruara paraprakisht. Detyrimisht ne pamë mundësinë që kemi në kaudër të projekteve ndërkombëtare që vinin ekstra në programet apo strategjitë kombëtare. Lajmi i mirë është që Shqipëria në muajin dhjetor u bë pjesë e fitimit të dy konsorciumeve në kuadër të “European Digital

Innovation Hubs” kjo është një strukturë brenda Digital Europe e cila financohet nga vendet anëtare, por në vitet e fundit ka futur edhe Ballkanin Perëndimor. Shqipëria është nga të paktat vende që mori dy projekte në një vit. Njëri nga projektet drejtohet nga një Institucion Akademik, dhe tjetri nga MEKI – është e para herë që MEKI-t i besohet një rol në koordinimin e projektit. Është për t’u thënë që ky projekt ka anëtarësi të OJF-vë, dhe janë të publikuara në faqen e BE-së dhe në faqet tona. Gjithashtu në kuadër të partneritetit EU4 Innovation apo Creative Economy, ka projekte ku parashikohet pjesëmarrja e shoqërisë civile në nivel përfaqësie dhe zhvillimi në gjithë procesin e realizimit të tyre. Kjo është diçka e re sepse më parë ka patur më shumë fokus në biznesin e vogël e të mesëm, tani ekziston edhe hapësira për organizatat e shoqërisë civile, e cila ka edhe hapësirat e veta për të komentuar Kjo nuk është vetëm meritë e MEKI-t por edhe e të gjithë pjesëmarrësve në proces. Por MEKI është partner politik me GIZ-in për Shqipërinë.

Duhet thënë edhe diçka në lidhje me **të drejtën e autorit** sepse është një argument shumë i rëndësishëm, me të cilën kemi pothuasje vite që punojmë me Zvicrën në kuadër të një bashkëpunimi, që ka një legjislacion shumë të pasur e të mirë dhe financon rishikimin e ligjit në fuqi e po punohet fuqimisht mbi bazën e një marrëveshje të bërë mes dy shteteve për këtë aspekt. Nuk kam informacion për gjendjen aktuale por po punohet ende për këtë aspekt. Nuk do doja të zbuloja më shumë tek pjesa e MEKI-t ne kemi patur edhe një mbledhje kabineti me Ministrin i cili e kishte vetë personalisht të pamundur që të merrte pjesë në këtë mbledhje, por më caktoi mua të përcillja anagzhimet më të fundit. Për mua është kënaqësi të jem i pranishëm dhe shpresoj të mos jetë hera e fundit.

Znj.Eglantina Bardhi: Të gjithë përfaqësuesit e ministrive u dëgjuan me shumë vëmendje dhe më duken të dhëna shumë optimiste, 70 projekte të financuar, 60, 5 milion euro projekte të fituara nga një organizatë lokale. Z. Jaupaj mua më pëlqen ideja që ndoshta organizatat e mëdha si GIZ-i, Auastrakët etj do largohen, por për mua duke qenë se ne punojmë me ta, kjo është frika më e madhe. Organizata që unë përfaqësoj, ne kemi 15 vite që jemi krijuar, kemi zbatuar rreth 130 projekte pikërisht nëpërmjet organizatave që u përmendën, dhe donatorëve tradicionalë, dhe është frikë e madhe – po e them hapur – që në momentin që do kalojnë financimet nga shteti, unë do ta mendoj seriozisht mbylljen e organizatës, dhe kam filluar madje, sepse nuk është qasja e institucioneve shtetërore, Znj.Seferi, që të mbështesë organizata të cilat bëjnë opionencë, japin rekomandime, vlerësime raporte. Dhe e di ku e shikoj unë këtë, tek qasja për shembull për të dhënë një përgjigje fare legjitime dhe bazike, pale t’i kërroj unë një Ministrie para se si do i bëj unë opionencën ministrisë.

Znj.Denada Seferi: Po provoje njëherë se po paragjykon.

Znj.Eglantina Bardhi: E kam provuar tre herë, e po flas me fakte, sepse unë kam qenë gazetarë, kam studier juridik, pra e kam provuar e dashur Zonjë.

Znj.Denada Seferi: Nuk jam Zonjë, jam Zv. Ministre.

Znj.Eglantina Bardhi: Po Znj.Zv.Ministre, e kam provuar dhe më është dashur, se ne punojmë në këtë treg dhe sigurisht është konkurrencë e hapur, dhe shikoj organizata që s'i njeh as google, ndërkohë një organizatë që ka kapacitete, ka 15 vite në treg ka zbatuar 130 projekte, ka aplikuar në mbi një mijë projekte, dhe është e pasuksesshme përballë një organizate të sapokrijuar që nuk e njeh as google, që minimumi një organizate për t'i parë aktivitetin e fut për kontroll të shohësh kush është, çfarë bën. Pra unë jam përballur me situatë të tilla ndaj më vjen keq ta them, nuk dua të ngre paragjykime, ndoshta mund të ketë një institucion model, por unë nuk kam arritur ta shoh, dhe shpresoj që të ngrihet një mekanizëm ndoshta i pavarur që këto fonde të kalojnë e të mos përfundojë në dorë të shtetit, nuk kam siguri.

Z. Sofjan Jaupaj: Jam shumë dakort me këtë që thoni, por duhet të keni parasysh edhe diçka. Të njëjtin paragjykim për shembull mund ta kem edhe unë për organizatën tuaj, e di pse e kam këtë paragjykim për organizatën që përfaqësoni? E kam sepse në diskursin që ju bëni, ju e shikoni komplet Shqipërinë si projekte pilote – unë nuk do të ndihesha shumë krenar të thosha që kam zbatuar fjala vjen 135 projekte, dhe shyqyr që është “çezma” e GIZ-it dhe UNDP që më mban gjallë.

Znj.Eglantina Bardhi: Pikërisht, sepse kanë qenë garant.

Z. Sofjan Jaupaj – po pra edhe ne këtë po themi, se ato fonde nuk janë të GIZ-it dhe UNDP, por të Shqipërisë. Prandaj unë po të them Zonjë merr “kovën” dhe shko te GIZ-i jo të të japë ai një “kanaçe” ujë. Pra kjo duhet të jetë qasja dhe lufta, sepse kjo të bën ty nesër të jeshë e aftë që të marrësh fonde.

Znj.Eglantina Bardhi – Dhe burimi duhet të jeni patjetër ju?

Z. Sofjan Jaupaj: Jo Ministria, sepse ty nesër do të të vi në treg edhe organizata e Kroacisë, e cila do të thotë e kam unë më të pasur CV seç e ke ti, kshuqë do e marr unë projektin që do e zbatoj, sepse do jemi një treg i brendshëm. Pra të qenëdojmë pas GIZ-it edhe UNDP etj – të cilat sigurisht i duam fort – por nuk mundet ta kemi më qasjen projekt-pilot këtu në Shqipëri.

Znj.Denada Seferi: Që t'i japim pak edhe përgjigje akuzës direkte.

Z. Vladimir Thano: Ka disa pikëpyetje çdo njeri që vjen në këtë tryezë, është normale.

Znj.Denada Seferi: Nuk ka nevojë të bësh avokatin e askujt. Nëse më drejtohesh direkt si Ministri e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kjo Ministri nuk ka fonde të drejtpërdrejta për organizatat civile, dhe nuk e di ku e ke nxjerrë këtë konkluzion që ne të kemi fonde për OJF-të.

Znj.Eglantina Bardhi: Unë ju thashë që kam bërë kërkesë për informacion dhe nuk e kam marrë, pastaj të shikosh mundësinë për projekte i bie që nuk do e keshë.

Znj.Denada Seferi: Po flasim për organizatat e shoqërisë civile të cilat nuk aksesojnë dot fonde nga Ministritë, pra në këtë prizëm kjo nuk ndodh. Prandaj nuk duhet të më drejtohesh për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sepse kjo nuk ndodh. Ndërkohë ajo që po themi me Sofjanin është që të ktheheni ju si GIZ-i apo UNDP pra të keni mundësi që ju të bëheni si ata, dhe ne të jemi krah jush që ta bëni këtë punë. Dhe jo se nuk e duam GIZ-in apo UNDP por t'ju mbështesim nëpërmjet këtij Këshilli Kombëtar.

Z. Sofjan Jaupaj: Pse nuk e çoni një kërkesë tek Delegacioni juve që të jeni zbatues të projekteve?

Znj.Fabiola Laço-Egro: Të lutem më lejoni të them diçka shkurt. Unë vërtetë e përgëzoj shumë qasjen që Z. Sofjan e tha këtu, që ne duhet të hapim sytë mendjen veshët që të rrisim kapacitetet jo nëpërmjet institucioneve, por nuk thamë deri në 2027 ç'do bëjmë ne - sepse ne si shoqëri civile jemi në një krizë shumë të madhe si në mbështetje financiare ashtu edhe të procedurave ligjore. Pra si do ta zgjidhim ne këtë ngërç sepse jemi në krizë tani edhe me largimin e donatorëve, apo USAID, pra është krizë shumë e madhe. Dhe pyetja është, a ka një plan emergjence a do bëhet një plan i tillë nëse ne nuk do kemi një mjedis mundësues, pra a do ngrihet një plan emergjence nga qeveria për t'i mbështetur strukturalisht? E dëgjova Arlindën dhe Albin, janë programe shumë të mira, thirrje shumë të mira, por janë tematike. Pra një organizatë "senior" nuk mund të hyjë me 130 projekte apo me 500 etj, në thirrjen e Arlindës (Ministritë së Rinisë) që është vetëm për organizata rinore dhe të fitojë një projekt që shkon 1.5 milion lekë për të marrë thjesht një projekt, dhe jo për ta mbajtur.

Znj.Denada Seferi: Kjo që po thoni ju Fabiola është ajo çfarë kemi diskutuar rëndomë në çdo tryezë – pra që Agjencia e Mbështetjes për Shoqërinë Civile duhet të jetë faktori, aktori kryesor që duhet të ketë buxhetin e duhur për të mbështetur shoqërinë civile, dhe ndoshta ka ardhur koha, edhe me Ligjin që po diskutojmë për ndryshim, që kjo Agjensi të jetë ajo që ekzekuton dhe implementon këtë ligj, që duke i dhënë mundësi në kuadër edhe të integritimit evropian që të mbështesë financiarisht shoqërinë civile – dhe kjo është qasja e duhur.

Z. Albin Gega: Faleminderit Z. Thanos, faleminderit të gjithëve. Unë do përpriqem të jem sa më konciz te ajo që do deklaroj, dhe do mundohem t'i jap përgjigje pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga ju, duke filluar nga vizibiliteti, vijueshmëria, interlokutorët dhe gjithashtu mekanizmat apo proceset. Nesër mblidhet një **Komision i Përbashkët** që është për herë të parë në Shqipëri, me Komisionin Evropian dhe atë Social Ekonomik. Vetë kur ishim në Bruksel muajin e kaluar u theksua rëndësia shumë e madhe e pjesëmarrjes në të të shoqërisë civile, u vlerësua me nota shumë pozitive i gjithë procesi, dhe sidomos pjesëmarrja në të e tre grupeve që janë shoqëri civile, sindikata dhe punëdhëns. Tek ky komision do flitet qartë për projekte, për atë që tha edhe Z. Jaupaj, që burimin ta keni ju dhe jo të flasë interlokutori për ju – pra ju do të jeni tek salla ku do të diskutohet për gjithçka, për projektet për pjesëmarrjen, lobimin çdo gjë – pra do të jeni aktorë kryesorë në këtë proces dhe unë e quaj si anëtarësim të parë të këtyre

tre organizatave në BE. Pa dyshim do jenë edhe pjesëtarë nga qeveria, por ju do të keni rolin tuaj dhe me sa di unë Kryetari është zgjedhur nga shoqëria civile.

Znj. Ermelinda Mahmutaj – Bashkëkryetari

Z. Albin Gega – Po flas për palën shqiptare, faleminderit që më inkurajon shpesh. Unë jam besimplotë që me këtë proces është një arritje shumë e madhe, sidomos me mundësinë që do keni për të marrë informacion dhe të keni mundësi për burime financiare duke qenë më afër këtyre burimeve. Do ta merrni informacionin e drejtpërdrejtë pa ju ndarë nga qeveria, do ta merrni informacionin të parët madje, kshuqë në këtë kontekst edhe përzgjedhja e bashkëkryetarit nga shoqëria civile tregon shumë, dhe ishte një kërkesë e tyre. Megjithatë sindikatat dhe punëdhënësit lobuan fort ta kishin bashkëkryetarin, ishte këmbëngulja e tyre që të ishte nga shoqëria civile.

Kalojmë tek **projekti i garancisë rinore** – ky është një projekt i cili është për të rinjtë 15-29 vjeç. Modeli i marrë është modeli estonez, një nga modelet më të suksesshme të garancisë rinore në gjithë Evropën. Akoma nuk kemi një afat përfundimtar për fillim e projektit, sepse ai duhet të kalojë njëherë në Qeveri e pastaj në Parlament. Por besoj deri nga shtatori duhet ta kemi si proces. Projekti ka një **fond prej 52 milion euro nga BE, 12 milion të tjera janë nga qeveria shqiptare** e cila është edhe faza e pilotimit. Projekti, mënyra se si ne e kemi dizenuar, është angazhimi i plotë i organizatave, që do të thotë që ju jeni në majë të procesit. Kjo skema është e vogël e ndoshta nuk duket për të gjithë, por këtu është AKPA si koordinator kombëtar dhe direkt më pas në skemë jeni ju, më pas janë agjensitë rajonale të punësimit, bashkitë, zyrat vendore etj, pra kjo do të thotë që qasja juaj do jetë shumë e drejtpërdrejtë dhe do keni rolin kryesor. Organizatat e shoqërisë civile do të angazhohen kryesisht në fazën e zbatimit dhe mbështetjes së garancisë rinore, duke luajtur një rol kyç në: Identifikimin dhe mobilizimin e të rinjve NEET - OSHC do të ndihmojnë në identifikimin e të rinjve që s'janë të punësuar, nuk janë as në arsim as në trajnim, duke siguruar një formim dhe ndërgjegjësim mbi mundësitë e garancisë rinore. Kjo do të thotë që ju jeni pjesa më thelbësore e “outreach-it”, që do të thotë që shtylla, projekti më i madh si në terma të rëndësisë por edhe në terma financiarë do të jetë outreach-i, sepse është procesi më i rëndësishëm outreachi i të rinjve. Ne morëm shkas nga programi i garancisë rinore në Estoni i cili ka rezultuar si projekti më i suksesshëm në Evropë, ku roli i shoqërisë civile ishte roli më i madh në këtë projekt. Ju keni sigurisht shpërndarjen tuaj me rrjetet tuaja në gjithë Shqipërinë dhe kjo do t'ju mundësojë juve që të jeni sa proaktivë por të jepni edhe një rol kontribues shumë të madh. AKP nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit do të akomodojë gjithë pjesën e derivimit të programeve qoftë për organizatat që do të përfshihen por edhe për të rinjtë. Pra do jetë një projekt shumë i rëndësishëm, dhe mund t'i kthejë edhe përgjigje pyetjes së Fabiolës, sepse drejtpërsëdrejti ky projekt mund të ndikojë në angazhimin tuaj të drejtpërdrejtë sepse pritet që jo më vonë se tetori 2025, ky projekt të fillojë.

Gjithashtu jo më larg se dje kemi nënshkruar një marrëveshje reciproke bashkëpunimi shumë të rëndësishme me Agjencinë e Punësimit Frances, që është Agjencia e Punësimit nga më të

mëdhatë e modernet në Evropë, të cilët kanë projekte shumë të mëdha në fushën e punësimit. Një nga shtyllat, përveç teknologjisë dhe zbatimi dhe marrja e teknologjisë nga ata, ishte edhe projektet e përbashkëta që do të kemi, por gjithmonë me shoqërinë civile. Agjensia i kushtonte një rol shumë thelbësor punësimit nëpërmejt shoqërisë civile si grupe të forta interesi të cilët kishin besim shumë të lartë te publiku, dhe përthithje më të madhe sa i përket personave që mund t'i përkasin kategorive të marginalizuara në jetën sociale. Ata kishinë dhe një slogan shumë të bukur “Një i ri një mundësi” i dedikohet të rinjve që e kanë një mundësi për punësim dhe një potencial për të dhënë.

Znj.Ermelinda Mahmutaj: Ladi të lutem ne kemi edhe diçka shumë të rëndësishme, sepse qëllimi i tryezës përveç përfshirjes së shoqërisë civile ka qenë kriza financiare, dhe do donim të thonim edhe disa gjëra në lidhje me këtë.

Z. Altin Hazizaj: Përsa i përket projektit të garancisë rinore jemi para një fakti që keni nevojë urgjente të rinovoni Komitetin ku merr pjesë shoqëria civile. Keni dy anëtarë që supozohen që janë rrjete komëbtare të cilat janë jofunksionale dhe për më tepër njëra prej tyre është edhe në borxhe rreth 800 ose 900 mijë euro – fakte këto që duhet t'i verifikoni, dhe me shumë mundësi është në ndjekje penale nga prokuroria. Është kërkuar edhe nga shumë anëtarë të tjerë, janë bërë kërkesa zyrtare, që të bëhet rinovimi i përfaqësimit të shoqërisë civile në këtë Komitet.

Z. Albin Gega: Këtë nuk e dija, por do ta verifikojmë patjetër. Për procedurë tani, kërkesat nuk kanë ardhur tek ne. Do ta ndjekim si problematikë.

Znj.Arlinda Topçiu: Nominimet fillestare në vitin 2022 në mos gaboj kemi bërë ne, dhe kanë qenë tre përfaqësuesit që konsideroheshin si organizata ombrellë. Ju keni shumë të drejtë sepse një lloj rifreskimi duhet bërë.

Z. Altin Hazizaj: Doja edhe të shtoja që ka disa programe, dhe këtë e kam për të gjitha ministrinë, që janë programe të BE-së, ku Shqipëria duhet të aderohet por nuk aderon. CERi ka qenë programi i fundit që është bërë funksional, dhe ju falenderojmë për këtë gjë, sepse është një program shumë i rëndësishëm, por ndërkohë janë edhe disa programe të tjera që në fakt Shqipëria duhet të japë dakordësim. Një nga këto programe më duket ka mbetur tek MEKI, nuk e di ekzaktësisht titullin por ka të bëjë në mos gaboj me mbështetjen sociale e prap më bën çudi që nuk është tek MSHMS. Por do e gjej si program dhe t'jua nis.

Z. Albin Gega: Për aq sa mbulloj unë nuk di që Ministria të ketë programe pezull për ndonjë arsye. Megjithatë do interesohem, nëse ma dërgoni emrin e projektit do e shoh patjetër ku ka mbetur. Kjo është një ide shumë e mirë, e programeve që do të aderojnë ministrinë, por do të shërbejë edhe tryeza e Komitetit të Përbashkët, ku nëpërmjet tyre ne marrim rekomandime, të cilat përkthehen në detyrime për ne.

Znj.Eniana Koçiaj: Shumë faleminderit vërtetë për prezantimet sepse këto ishin informacione të vlefshme jo vetëm për ju por edhe për ne si përfaqësues të qeverisë, sepse tashmë me këtë

forcë që po merret shteti shqiptar për të mbështetur shoqërinë civile, megjithë pakënaqësitë apo hapësirat që ka për përmirësime, sidoqoftë informacioni është me interes edhe për ne. Unë shkurtimisht do ju bëj një përmbledhje, besoj se jeni të gjithë familjarë me mënyrën se si funksionon AMSHC, me thirrjet të cilat kanë që në 2009 që hapen dhe janë publike. Unë dua të përmend vetëm që buxheti i të paktën 3-4 viteve të fundit i alokuar për shoqërinë civile pranë AMSHC është **rreth 100 milion lekë, pra rreth 1 milion euro**. Kjo është një shifër, e cila, nga aplikimet që na vinë ne, mbulon pothuaj 1/3 e tyre – pra kemi çdo vit 3 milion euro kërkesa nga aplikimet, po e përafroj, e ndërkohë fondi i rezervuar për këto aplikime mbulon vetëm një të tretën. Thirrja hapet çdo vit, thirrja për vitin 2025 do hapet brenda këtyre dy muajve.

Prioritetet, ndryshe nga ministritë e tjera, AMSHC i nxjerr në radhë të parë nëpërmjet konsultimeve publike dhe takimeve informuese që bëhen me shoqërinë civile në rang kombëtar, dhe ndjek patjetër prioritet qeveritare. Për shembull për vitin 2024 ka patur disa prioritet të cilat nuk kanë qenë më parë, ose më qartë ideja është që të jenë sa më gjithëpërfshirëse dhe aktuale, duke qenë se qëllimi është mbështetja e shoqërisë civile, prioritetet nuk janë aq tematike sa ç'mund të jenë për shembull nga Ministria e Rinisë, apo e Kulturës që u prezantuan pak më parë. Pra kjo sa ç'është e mirë nga njëra anë, është edhe pak penalizuese, sepse shpërndahet ky fond që s'është i mjaftueshëm me kaq shumë prioritet. Ajo që doja të thoja unë është që prioritet e vitit 2024 kanë qenë të fokusuara shumë edhe tek **forcimi i pushtetit vendor**, një nga arsyet kanë qenë edhe politikat që lidhen me fondet e kohezionit. Ideja është që pushteti vendor duhet të fuqizohet shumë pas futjes në Bashkimin Evropian sepse do jetë edhe ai aktor i rëndësishëm që do menaxhojë fonde me përfitimin që Shqipëria do ketë nga politikat e kohezionit. **Forcimi i drejtësisë dhe i llogaridhënjes**, që është edhe një detyrim prej 20% nga buxheti që AMSHC duhet t'i kalojë programeve që lidhen me reformën në drejtësi, e veçanërisht në vitin 2024 ky prioritet ka patur një fokus dhe mbështetje të shtuar për median investigative dhe monitorimin e reformës në drejtësi. Ka patur gjithashtu mbështetje për **nxitjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve**, ka qenë pothuaj prioritet çdo vit, ndoshta jo aq shumë fokus tek fëmijët, por tek rinia. **Zhvillimi i qendrueshëm ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit** edhe ky ka qenë një prioritet i përvitshëm i Agjensisë, sikurse edhe **integrimi evropian** që nuk na ndahet si prioritet në çdo thirrje. Dhe prioriteti i fundit, **dimensioni dixhital për dhunën me bazë gjinore**, i cili është një prioritet që nuk ka qenë në thirrje të tjera.

Për vitin 2025 jemi në mbyllje të fazës së konsultimeve në rang kombëtar. Do mblidhet bordi drejtues me shumë mundësi brenda këtij muaji, të cilët pastaj edhe në bazë të prioritetëve qeveritare, sepse ecet paralelisht me to, do të vendosin edhe prioritet e thirrjes. Edhe diçka të fundit që do doja të shtoja, **shtrirja territoriale** e projekteve për AMSHC është një kusht, gjithashtu edhe mbështetja e organizatave të reja (që të gjenden me “google” search), me aq mundësi sa jep AMSHC, të mund të forcohen. Sigurisht Bashkia e Tiranës është Bashkia që përthith më shumë projekte, nga 73 projekte që janë fituar në vitin 2024, 28 projekte janë fituar në qarkun e Tiranës, nga të cilat 26 vetëm nga Bashkia e Tiranës. Shoqëruar pastaj nga Qarku i Vlorës rreth 13 projekte – kjo ishte shkurtimisht ajo që mund të thoja. Për çdo informacion tjetër raporti vjetor është tek faqja e AMSHC dhe është i ndarë sipas prioritetëve, përqindjes së projekteve, pra është informacioni sasior shumë i detajuar. Faleminderit!

Z. Vladimir Thano: Faleminderit Znj.Koçiaj, edhe për shkak të afërisë që kemi me Agjensinë e Shoqërisë Civile, por edhe si Sekretariat, duke e falenderuar. Këshillin e keni aleat besoj në kërkesat që mund të keni për një rol më të fortë në atë që quhet mbështetje e shoqërisë civile dhe problematikave që hasim. Në një nga diskutimet e tjera një nga pikat dhe çështjet që ne kemi ngritur, ka të bëjë me garantimin e stabilitetit të shoqërisë civile kur donator të mëdhenj nuk ekzistojnë më, ose tërhiqen dhe krijojnë hapësira për mos stabilitet dhe mosfunksionalizim të shumëçka që shoqëria civile ka ngritur me shumë mund. Ne si anëtarë të shoqërisë civile në këtë Këshill jemi krejtësisht të shqetësuar, nuk e di si do të ndajmë me autoritet publikë me këtë pjesë.

Znj.Ermelinda Mahmutaj: Ne e kemi nxjerrë të gjithë së bashku këtë shqetësim që lidhet me brishtësinë financiare të organizatave megjithatë ne mund ta shikojmë këtë gjë në dy linja, mbi të cilat mund të ngremë edhe planin e punës. E para është vizioni dhe përgatitja e sektorit për të përthithur fonde, që shkon në linjën që tha Sofjani, pra sikundër qeveria do të jetë në një det të hapur për detyrat e reja që do ketë në BE, ashtu edhe shoqëria civile do ketë një konkurrencë shumë më të lartë dhe ne duhet t'i përthithim këto fonde në mënyrë të drejtpërdrejtë, ku për mua të paktën aq sa kemi në dorë për fondet që vinë në Shqipëri, konkurrencën pastaj nuk e përshtasim dot – vërtetë nuk duam që organizata si GIZ-i të na konkurojnë, por edhe duhen mekanizma që ato të mos konkurojnë në mënyrë të barabartë me ne. Pra që këtu duhet të fillojë pak se si ne mund t'i integrojmë. Gjithashtu edhe rritja e kapaciteteve është shumë e rëndësishme, kjo është një linjë në të cilën ne mund të punojmë bashkërisht se si ta lehtësojmë përthithjen e fondeve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por linja tjetër që nuk duhet harruar është edhe se si qeveria shqiptare pastaj ofron qendrueshmëri për sektorin ku roli i AMSHC është shumë i rëndësishëm. Unë këto dy linja shoh - pra ne duhet të shohim në mënyrë vizionare por ama kemi një krizë afatshkurtër, e cila do na nxjerri nga loja madje edhe shumë organizata senior. Ne jemi përballë faktit që shumë organizata kanë mbyllur dyert në mënyrë të menjëhershme.

Z. Indrit Seferi: Kam nevojë të shtoj edhe unë diçka. Mendoj që duhet të bëjmë edhe ne si shoqata bashkë me AMSHC një identifikim të gjithë shoqatave që operojnë e t'i ndjamë në nivele të performancës që kanë patur këto 34 vjet. Pra duhet matet në mënyrë të saktë dhe jo mbi bazë perceptimesh, pra mendoj që kjo duhet bërë, që edhe ne nga ana jonë të bëjmë një lloj identifikimi së bashku me regjistrin e famshëm elektronik të shoqërisë civile, pra e para kush janë këto shoqata aktive apo pasive si kanë performuar ndër vite.

Z. Vladimir Thano: Propozoj që të ngrihet një grupë pune tematik më i vogël për këtë gjë. Jemi të gjithë dakort. Ok ju faleminderit shumë e konsideroj mbledhjen të mbyllur. Duke falenderuar edhe sekretariatin për mbarëvajtjen e procesverbalit, e nisëm pak të vullshëm por besoj që çdo gjë shkoj mirë.